

LANÇ, lufta e sakrificave të mëdha

Shqiptarët, të lirë dhe krenarë në përvjetorin e 69-të të çlirimit të atdheut

Nga Rrahman PARLLAKU

FAQE 3



70-vjetori, Brigada partizane që u inaugurua ditën e Pavarësisë

Brigada e Dytë Sulmuese dha mbi 85 dëshmorë në altarin e lirisë gjatë LANÇ të popullit shqiptar

Nga Edip OHRI

FAQE 4



ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 67 (298) NËNTOR 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA Adresa: Ministria e Mbrotjtjes, Tiranë. Email: veterani.obvl@yahoo.com/ website: WWW.VETERANIOBVL.ORG

Integrimi european si proces mbarëkombëtar

Nga Halil RAMA

Në samitin e partisë popullore europiane, kryetari i partisë demokratike Lulzim Basha u ka kërkuar liderëve europianë të djathtë të mbështesin statusin e kandidatit për Shqipërinë. Sipas Bashës, interesi kombëtar mbizotëron mbi çfarëdolloj mosmarrëveshje të brendshme. Statusi i vendit kandidat jo vetëm që ofron...

FAQE 6

Simboli i pavarësisë së kombit

Nga Valsin TANELLARI

Në çastet më të vështira për pop ulla shqiptar, kur krerët e Lëvizjes Kombëtare bënin çmos për mbrojtjen e vendit nga copëtimi, vendimtare ishte nisja e Ismail Qemalit nga Stambolli për në Bukuresht. Në historinë e diplomacisë shqiptare shkruhet se Ismail Qemali arriti të përfitonte nga kundërthëniet ekzistuese të Fuqive...

FAQE 6

OUPLSH, 22-vjet veprimtari në dobi të profesionalizmit ushtarak

Nga Dhimitër NDRENIKA

Përmbysja e sistemit ekonomik e politik të centralizua, ai i partisë-shtet, rrjedhojë e teorive euforike të mundësisë së barazitizmit shoqëror dhe e veshjes së sistemit faktik feudal të diktaturës së proletariatit me pamje socialiste, krijoi hapësirat e duhura dhe për ushtarakët që të trajtoheshin si qytetarë me kontribute...

FAQE 11

KODHELI NË MINISTERIALIN E MINISTRAVE TË MBROJTJES NË BRUKSEL

SHQIPËRIA, E AFTË PËR TË MARRË PËRGJEGJËSI BRENDË NATO-s



FAQE 2

Një nga brigadat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila u inkuadrua në Diviziononin e V-të Sulmues

Brigada e V-të luftoi për çlirimin e Kosovës dhe Sanxhakut

FAQE 5

MIRNIJE MALINDI - personifikim i sakrificës dhe përkushtimit familjar



FAQE 9

AKADEMI PERKUJTIMORE NE PLAVE

Isuf Kamberi, luftëtar i denjë në mbrojtje të trojeve shqiptare të Plavës e Gucisë

FAQE 14-15

SHËNIME NGA RAPORTI I PUNËS SË SHOQATËS SË VETERANËVE TË LANÇ TË KOSOVËS NË PERIUDHËN 2012 - 2013

Vehap Shita zgjidhet kryetar i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës

FAQE 7

100 VJETORI I LINDJES SË SHKRIMTARIT TË MADH

Simpozium për Petro Markon në Krajova të Rumanisë

FAQE 16

KODHELI NË MINISTERIALIN E MINISTRAVE TË MBROJTJES NË BRUKSEL, TAKIM ME RASMUSSEN DHE HAGEL

Shqiperia, rol pozitiv për sigurinë dhe mirëqënien e rajonit

• *"Jam i lumtur për rolin e Shqipërisë në Aleancë dhe për gatishmërinë e marrë nga kryeministri Edi Rama në takimin e zhvilluar së fundmi", deklaroi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, në takimin e zhvilluar në Bruksel me Ministren e Mbrojtjes, Mimi Kodheli.*

Zyra e shtypit e ministrisë bën të ditur se ministrja Kodheli mori pjesë në ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, që u mbajt në selinë e NATO-s në Bruksel, ku zhvilloi një takim bilateral me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen dhe Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes, Chuck Hagel.

Në hapje të takimit, Rasmussen i uroi mirëseardhjen në selinë e NATO-s ministres Kodheli dhe e përgëzoi atë për detyrën e re.

Duke u ndalur në takimin e ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtarë të NATO-s, ai u shpreh se ky takim do të shërbejë si hapi i parë drejt Samitit të NATO-s 2014.

Sekretari i Përgjithshëm Rasmussen nënvizoi kontributet pozitive të Shqipërisë në operacione, nisma rajonale dhe në mbështetje të iniciativës "Smart Defence", ku Shqipëria është pjesë aktive e saj.

Duke bërë një rezymë të shkurtër të takimeve, në formate të ndryshme, z.Rasmussen theksoi se priste diskutime të gjera mbi çështjet dhe sfidat tona të përbashkëta. Në fund të fjalës së tij, ai u shpreh i lumtur për rolin e Shqipërisë në NATO dhe pret të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet shqiptare në të ardhmen.Në këtë kontekst, ai

përmendi takimin e zhvilluar së fundmi me kryeministrin e Shqipërisë, z.Edi Rama.Ministrja Kodheli i dorëzoi nga ana e z. Rama si dhuratë z. Rasmussen edhe një pikturë.

Nga ana e saj ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, falenderoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s për pritjen që i rezervoi, në këtë pjesëmarrje të parë të saj në Ministerialin e Mbrojtjes të NATO-s. Ajo e siguroi Sekretarin Rasmussen për mbështetjen dhe dedikimin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe të saj personal, në adresimin e çështjeve dhe sfidave të përbashkëta, për një Aleancë më të fortë. Shqipëria, theksoi znj.Kodheli, beson se NATO luan një rol të pazëvendësueshëm në Kosovë dhe për këtë falenderoi lidërshtetjet e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

Në lidhje me zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, ministrja Kodheli shprehu rolin pozitiv të Shqipërisë në mbështetje të paqes, sigurisë dhe prosperitetit, duke investuar me tepër për mirëqenien e rajonit. Kontributi i Shqipërisë në ISAF, KFOR etj., do të vazhdojë të mbështetet plotësisht, sidomos në kuadër të ISAF-it, pas vitit 2014. Znj.Kodheli u shpreh se Sh-



qipëria do vazhdojë të punojë drejt transformimit të Forcave të Armatosura, modernizimit, interoperabilitetit, për të përmbushur obligimet si një vend aleat dhe i besueshëm.

Është bindja ime, vazhdoi më tejKodheli, që një theks të veçantë do vihet në luftën kundër korrupsionit në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes, për të poseduar një forcë të armatosur moderne, të mirëpërgatitur dhe profesioniste.

Në fund të fjalës së saj, ministrja Kodheli i solli Sekretarit Rasmussen urimet më të mira të Kryeministrit Rama dhe vendosmërinë e qeverisë shqiptare për të qenë një partner i denjë në këtë Aleance.

Rasmussen, duke falenderuar

znj.Kodheli për mbështetjen e saj, uroi për takime të tjera të frytshme, ndërsa theksoi se megjithëse burimet mbeten të vogla, ato duhen përdorur me kujdes.

Nga ana e saj, ministrja Kodheli edhe njëherë theksoi, se pavarësisht nga gjendja e vështirë financiare, Shqipëria do të vazhdojë të bëjë më të mirën për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, zhvilloi një takim edhe me Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes, Chuck Hagel, me kërkesën e tij.Pasi e uroi për detyrën e re si ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, z. Hagel vlerësoi bashkëpunimin me Shqipërinë. Ai e siguroi ministren

Kodheli për mbështetjen e padiskutueshme për ekipin e ri qeverisës dhe nënvizoi faktin se po kërkohen fusha të reja bashkëpunimi. Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, e falenderoi Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes, Hagel, për mbështetjen e SHBA-ve ndaj qeverisë shqiptare, si dhe i bëri ftesën e qeverisë për të vizituar vendin tonë, ftesë të cilën z. Hagel e pranoi me kënaqësi.

Gjatë Ministerialit të NATO-s, që u mbajt në Bruksel, u diskutua një gamë e gjerë çështjesh si mbrojtja kibernetike, burimet, Afganistani, zhvillimi i kapaciteteve, etj, të cilat do të jenë dhe objekt diskutimi në Samitin e ardhshëm të NATO-s në vitin 2014.

Të aftë për të marrë përgjegjësi brenda NATO-s

Shqipëria tani është më e aftë për të marrë përgjegjësi brenda NATO-s me burimet e kërkuara të mbrojtjes, tha ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, gjatë Konferencës finale për Integrimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në NATO.

Në fjalën e saj ministrja Kodheli tha se ky është moment krenarie për të gjithë ne. "Përparimet tona janë të mëdha në një sërë fushash, si institucionalizimi i strukturës si një forcë plotësisht profesionale, planëzimi i mbrojtjes, plotësimi i Rishikimit Strategjik i Mbrojtjes, standardizimi, modernizimi i FA, trajnimet dhe stërvitjet. Është në vazhdimësi puna për Strategjinë e re Ushtarake, planifikimi për kapacitetet e synuara, si dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura, i cili do të pasqyrohet në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes", tha ministrja e Mbrojtjes. Në këtë kuadër, Kodheli tha se "transformi-



mi është një sfidë e vazhdueshme dhe si e tillë ne duhet të gjejmë balancën ndërmjet çështjeve të përditshme dhe të mendojmë për të ardhmen".

Kodheli garantoj se, në cilësinë e Ministres së Mbrojtjes, mbetet e angazhuar për të drejtuar stafin ushtarak dhe civil për të ndërmarrë veprime të sigurta dhe për

të siguruar që procesi i Transformimit të këtë energjitë e duhura, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë.Sfida e radhës, tani që përfundoi faza e integritetit, për Kodhelin, është veprimi që duhet bërë për të siguruar që kapacitetet dhe forcat tona t'u përgjigjen kërkesave të Aleancës, të maksimizojnë përdorueshmërinë si

dhe të rrisin cilësinë për të përballuar sfidat e së ardhmes, aftësinë e tyre për rolin që kemi në të ardhmen në NATO, sidomos tani që Aleanca përgatitet për të tërhequr forcat e saj nga Afganistani pas vitit 2014.

Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros, tha se "katër vjet më parë, kur Shqipëria iu bashkua Aleancës, FA Shqiptare janë tashmë në prag të vlerësimit të integritetit të tyre në strukturat dhe Komandat e NATO-s në nivel operacional dhe strategjik, si dhe për të marrë të gjithë përgjegjësitë e tyre".

Gjenerali Palomeros shtoi se "lajmi i mirë është se si anëtare e plotë e familjes transatlantike, Shqipëria mund të mbështetet më shumë se kurrë në solidaritetin dhe ekspertizën e Aleancës, sidomos drejt objektivit për një forcë të mirëtrajnuar dhe pajisur "Forcat

Shqiptare 2020", e aftë të operojë përgjatë një spektri të gjerë misionesh dhe detyrash".

Në mbyllje të fjalës së tij, Palomeros tha se "Shqipëria mund të mos jetë vendi më i madh i NATO-s, por madhësia nuk ka shumë rëndësi në familjen tonë të madhe.Ashtu siç është shprehur Nënë Tereza "ne do të jemi besnikë ndaj gjërave të vogla, sepse aty varet fuqia jonë".

Më pas u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët, si dhe u dha edhe një Komunikatë për Shtyp nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi dhe komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros.

Qëllimi i Konferencës ishte identifikimi i mësimave të nxjerra dhe arritjeve të deritanishme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në procesin e integritetit me NATO-n.

Shqiptarët, të lirë dhe krenarë në përvjetorin e 69-të të çlirimit

LANÇ, lufta e sakrificave të mëdha

- **Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve. E çliruam Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë.**
- **Ne shprehim falenderimet tona për ndhmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë.**

Nga Rrahman PARLLAKU

Shqiptarët e festojnë këtë vit përvjetorin e 69-të të çlirimit të Atdheut nga okupatori nazi-fashist më të gëzuar e më krenarë se kurrë, të bindur se në dhjetor Shqipëria do të marrë statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Europian.

Ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme, Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane.

Në momentin historik populli shqiptar, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo që jetojnë në trojet e tij etnike u bashkua me forcat e lirisë kundër atyre të errësirës. Në bazë të kësaj lufte e sakrificave që bëmë, ne siguroam jo vetëm pavarësinë e Shqipërisë por të drejtën e shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje e të shqiptarëve kudo që jetojnë, të drejtën për të qëndruar në trojet e tyre etnike. Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit në Vlorë.

Në Luftën e Dytë Botërore gjithë populli shqiptar ishte në rrezik. Shqipëria mund të humbiste pavarësinë. Populli shqiptar i Kosovës e ai i shqiptarëve të tjerë në trojet e tyre etnike mund të shpënguleshin nga trojet e tyre e të pësonin fatin e atyre shqiptarëve që u dëbuan me forcën e armëve nga serbët në vitet 1870-1880 nga zonat e Nishit, Vranjës, Prokupjes, Leskocit etj dhe të popullit çam.

Ky rrezik vinte sepse pushtuesit italianë erdhën me parullën e bashkimit të shqiptarëve nën kurorën e Viktor Emanuelit; krijuan qeverinë kuizlinge për ti dhënë pamjen e një shteti të pavarur dhe me shkatërrimin e Jugosllavisë dolën me parullën e Shqipërisë së Madhe. Në këtë mënyrë u përpoqën ta lidhin popullin tonë me bllokun fashist.

Të njejtën rrugë ndoqi edhe Gjermania Naziste pas kapitullimit të Italisë duke mbledhur një Asamble Tradhtarë që e shpalli Shqipërinë të Pavarur, pasi gjermanët kishin deklaruar se "ne jemi kalimtarë dhe Shqipëria do të jetë e pavarur!". Vetëkuptohet, pavarësi me nazistët brenda në Shqipëri!.

Me këto parulla ata u përpoqën ta joshnin popullin shqiptar, ta mbanin të lidhur me ta dhe me ndihmën e kuizlingëve bashkëpunëtorë të tyre ta vinin në interes të tyre kundër Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Po të mos kishte filluar e zhvillohej Lufta Nacionalçlirimtare, kombi shqiptar do të kishte shkuar në humnerë bashkë me nazifashistët dhe do të ishin plotësuar lakmitë grabitqare sllavo-greke për copëtimin edhe të shtetit shqiptar, për të cilat punonin edhe qeveritë mbretërore greko-serbe në egzil.

Ishte zhvillimi i Luftës Naciona-

lçlirimtare që përfshiu gjithë Shqipërinë dhe që vetëm brenda vitit 1942 ishin krijuar 22 çeta partizane nga Konispoli në Jug deri në Malësinë e Gjakovës në Veri, jehona e kësaj lufte bëri që ministrat e jashtëm të Anglisë-Iden, i Bashkimit Sovjetik, Mollotov dhe i SHBA-Hell në Dhjetor 1942 të bënin deklaratën "që dëshëronin ta shihnin Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe të vendoset pavarësia e saj. Forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendoset në Shqipëri do të jetë një çështje që do ta vendosë vetë populli shqiptar në fund të luftës".

Megjithëse në këtë deklaratë qeveria angleze mbante një rezervë kur shprehej se "e sheh çështjen e kufijve shqiptarë pas Luftës si një çështje që duhet të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes". Kjo deklaratë ishte mbështetje për qeveritë greko-jugosllave në egzil që përgatisnin plane për copëtimin e Shqipërisë.

Por Lufta Nacionalçlirimtare kishite marrë zhvillime të vrullshme që me krijimin e reparteve sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm me 10 Korrik 1943, ky shtab mori në drejtim dhe çentralizoi veprimet luftarake duke u shtuar goditjet kundër pushtuesve u krijuan zona të lira. Në këto momente aleatët e në radhë të parë anglezët dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm të cilët ndiqnin nga afër Luftën tonë dhe u bindën se e vetmja forcë ushtarake e organizuar në Shqipëri që bënte Luftë të vendosur kundër pushtuesve nazifashistë ishte Ushtria Nacionalçlirimtare. Pas kësaj bindje ata i shtuan misionet e tyre në Shqipëri dhe filluan të na ndihmojnë me armatime e materiale luftarake, megjithëse shumë të kufizuara për shtimin e zgjerimine Ushtrisë sonë gjatë viteve 1943-1944.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e ushtrive aleate bënë të gjitha përpjekjet për ti bashkuar e futur në luftë forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar e Legalitetit, por nuk patën sukses.

LANÇ, lufta e sakrificave të mëdha

Ushtria Nacionalçlirimtare pasi theu me sukses Operacionin më të Madh të Forcave Naziste e bashkëpunëtorëve të tyre në dimrin e egër të viteve 1943-1944 e kish çliruar hapësira të mëdha të vendit, krijoi kushte për mbajtjen e Kongresit Antifashist në qytetin e çliruar të Përmetit. Nga ky Kongres doli komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore. Pas Kongresit u bënë ndryshime në organizimin e Ushtrisë. Ajo kaloi nga formacionet e Brigadave në ato të Njësieve të Mëdha të Divizioneve e Koparmatave, të afta për të kryer operacione operative strategjike në të gjitha hapësirat e vendit.

Me thyerjen e operacionit gjerman të Qershorit '44, i fundit i ndërmarrë nga nazistët në vendin tonë, në korrik 1944 forcat e Divizionit të Parë kaluan në mësymje për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, dhe me çlirimin e Matit, të Dibrës e të Lumës, Brigada e Pestë u shkëput nga varë-

sia e Divizionit të Parë dhe së bashku me Brigadën e Tretë morën urdhër të kalojnë në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj.

Detyra kryesore që na ngarkonte Shtabi i Përgjithshëm ishte që në bashkëveprim të ngushtë me forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës të godisnim pa ndërprerje forcat naziste e të shpejtonim çlirimin e Kosovës; të ndihmonim që rinia kosovare të merrte pjesë masive në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me qëllim që Kosova të bëhej pjestare e aleancës antifashiste të popujve që luftonin kundër nazistëve dhe në këtë mënyrë të fitonte të drejtën për vetëvendosje; të ndihmonim për ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara. Për realizimin e këtyre detyrave e drejtimin e veprimeve luftarake u krijua Shtabi i përbashkët Operativ i dy Brigadave dhe Forcave të Kosovës, i përbërë nga Fadil Hoxha-komandant i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës, Shefqet Peçi -komandant i Bvrigadës së Pestë dhe Hulusi Spahiu-Komandant i Brigadës së Tretë.

Megjithë rezistencën e ashpër të forcave naziste e të mbeturinave të Divizionit ESS Skënderbeg për të mbajtur qytetet Prizren, Gjakovë e Pejë e për të siguruar tërheqjen e shpejtë e të organizuar të reparteve naziste për në Frontin Perëndimor kundër forcave aleate, forcat tona i mundën e i shpartalluan nazistët me luftime shumë të ashpra që u zhvilluan në Gjakovë e sidomos në Junik e Deçan. Në këto luftime Brigada e Tretë ka pas humbjet më të rënda në historinë e saj luftarake; 32 të vrarë e shumë të plagosur. Edhe armiku pati humbje të rënda-shumë të vrarë e të plagosur; shumë me sa më kujtohet rreth 30 rob nga forcat e Divizionit Skënderbeg pasi kishin nxjerrë nga rrethimi komandanët e tyre nëpërmjet një çepengu. Mes tyre kishin qenë Rexhep Deva, Demali Pozhari, një oficer gjerman e të tjerë. Partizanët tanë, të zemëruar nga humbjet e shokëve të tyre kërkonin me këmbëngulje pushkatimin e robërve. Me shumë vështirësi i bindëm ti lirojmë, pasi ne nuk kishim shkuar në Kosovë për të vrarë vëllezërit tanë po për çlirimin e tyre. Atyre u morën armët e i liruam duke i porositur të mos shkonin prapë në shërbim të armikut e të vriteshin vëlla me vëlla siç ndodhi në ato luftime.

Duhet ta pohojmë se prej asaj dite, pushkë kosovari nuk qëlloi më kundër nesh. Luftimet për çlirimin e Deçanit, Pejës e gjithë Rrafshit të Dukagjinit përfunduan me 17 nëntor 1944.

Na vjen keq kur dëgjojmë a shkruhet në ndonjë gazetë se forcat tona kanë vrarë njerëz të pafajshëm në Kosovë. Unë pohoj se kjo nuk ka ndodhur në asnjë rast, përveç kur jemi bdodhur ballë për ballë në luftime. Nuk e di a jeton ndonjë nga të liruarit të jetë dëshmitar i kësaj.

Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha ndihmesë për pjesëmarrjen e djemve të saj në Luftë

Pjesëmarrja masive në Luftën Nacionalçlirimtare e popullit të Kosovës nën drejtimin e Fadil Hoxhës e shokëve të tij ka qenë vendimtare. Ajo



bëri të dështojnë planet e Çubrolloviçit që i kishte servirur komandës së Ushtrisë Jugosllave për spattrimin etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre.

Arkitekt i mendimit shovinist serb Vasaçubrolloviçi me elaboratorin e tij të dytë të vitit 1944 jepte direktivën politike se paskësh ardh momentit i përshtatshëm për ti larë hesapet me shqiptarët njëherë e përgjithmonë; se për ti dëbuar nga trojet e tyre....."asnjëherë ne nuk kemi pasur kushte më të favorshme". "Lufrat,-vazhdon më tej ai, janë momenti më i përshtatshëm për zgjidhjen e këtyre problemeve". Ai shpreh bindjen se "aleatët tanë do të na kuptojnë dhe do të plotësojnë dëshirat tona, veçanërisht një shpresë të madhe kemi tek Bashkimi Sovjetik vëlla". Dhe në fund ideologu shovinist serb jepte direktivën për ushtrinë "Ushtria gjatë operacioneve luftarake duhet të spastrojë në mënyrë të planifikuar e pa mëshirë pakicat kombëtare shqiptare".

Edhe Konferenca e Tre të Mëdhenjve (Çurçill-Stalin-Rustevlt) u jepte të drejtë shteteve fituese në luftë për shpërnguljen e pakicave kombëtare që ishin bashkuar me bllokun fashist. Shembull konkret ishin Rumania që iu shkëput një republikë e tërë-Moldavia nga trojet e veta, pa llogaritur shpërnguljen e më se dhjetë milionë gjermanëve nga Prusia, Krakovia, etj....

Platforma politike dhe ushtarake e Çubrolloviçit, e mbajtur sekret nga Beogradi për çështjen e Kosovës u dogj nga 55 mijë djemtë e saj që morën pjesë në Luftë dhe mijëra dëshmorëve kosovarë që dhanë jetën duke luftuar përkrah forcave antifashiste të botës. Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha ndihmesë për pjesëmarrjen e djemve të saj në Luftë.

Me largimin e Brigadave tona nga

Kosova, në drejtim të Sanxhakut e Bosnjës, forcat serbo-sllave përfshi dhe ato çetnike u përpoqën të vënë në zbatim planin e Çubrolloviçit, por ishte vonë. Forcat shqiptare ishin të armatosura; ata bënë qëndresë të fortë duke luftuar për jetë a vdekje nën komandën e Shaban Palluzhës. Krimet qenë të rënda, por planet e Çubrolloviçit nuk u realizuan. Shqiptarët mbetën përjetë në trojet e tyre etnike. Forcat e dy Divizioneve tona e vazhduan luftën në tokat e Jugosllavisë, duke dhënë ndihmesën e tyre, jo vetëm në çlirimin e krahinave të Malit të Zi, Sanxhakut e Bosnjës por edhe duke penguar, dëmtuar e vonuar forcat naziste që përpiqeshin të tërhiqeshin me shpejtësi e në mënyrë të organizuar për në Frontin e Perëndimit, për të luftuar kundër forcave aleate që kishin zbarkuar në Francë. Luftimet e forcave tona në këto vende janë zhvilluar në kushte tepër të vështira, të një dimri që u kujtonte atë të dimrit '43-'44 në Shqipëri, me mungesë të theksuar në ushqime e mjete të tjera të jetesës. Por ata e kryen me nder detyrën. Dua t'iu kujtoj se në këto luftime kanë rënë afër 600 dëshmorë të dy divizioneve tona. Ky ishte edhe një kontribut i veçantë në Luftën Antifashiste.

Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve; E çliruam Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë.

Patjetër, ne shprehim falenderimet tona për ndhmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë.

Lavdi dëshmorëve të Kombit tonë të të gjitha Luftave çlirimtare.

Brigada e Dytë Sulmuese dha mbi 85 dëshmorë në altarin e lirisë gjatë LANÇ të popullit shqiptar

70-vjetori, Brigada partizane që u inaugurua ditën e Pavarësisë

• *Më 28 Nëntor mbushen shtatëdhjet vjet nga dita e krijimit të Brig.II-të S. Populli ynë dhe ne veteranët e LANÇ përulemi me respekt përpara veprës të partizanëve shqiptarë në përgjithësi dhe veçanërisht atyre të Brig.II-të S, të cilët bashkërisht nënshkruan me grykën e pushkës çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit e huaj duke e rreshtuar vendin tonë në krah të koalicionit të madh antifashist botëror që drejtohej nga aleatët e mëdhenj SHBA, BS dhe Britania e Madhe*



Nga EDIP OHRI*

Brigada e Dytë Sulmuese është një nga formacionet e para të mëdha partizane, e cila si pjesë përbërëse e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u krijua me vendim dhe me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm qysh në tetor 1943. Por do të ishte data 28 Nëntor (dita e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë) data zyrtare e krijimit dhe fshati Shëngjergj i Tiranës vendi ku u inagurua Brig.II-të S.

Dita e inagurimit të saj shënoi një ngjarje me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake si për UNÇSH ashtu edhe për mbarë Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare të vendit.

Siç dihet Brig.II-të S pati si bazë të formimit të saj zonën e Shëngjergjit, Çermenikës dhe Martaneshit që ndodheshin në qendër të Shqipërisë me hapësira territoriale të çliruara e me baza të siguruara të furnizimit në juridiksionin e qarkut ushtarak partizan që drejtohej nga Kadri Hoxha. Përsa i përket bazës shoqërore politike të zonës ku u formua Brigada, ajo banohej nga fshatarë të varfër por patriotë të cilët përbënin shumicën dërmuese të banorëve të këtyre krahinave. Prandaj kur Fronti NÇL lëshoi kushtrimin e luftës për liri kundër pushtuesve të huaj, populli i këtyre krahinave u ngrit i tëri në këmbë qysh në prill 1942 dhe u lidh ngushtë me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare duke e përkratur atë pa rezerva moralisht e materialisht, si dhe me pjesëmarrje direkte në formacionet luftarake partizane. Po kështu populli i këtyre krahinave kontribuoi me strehimin dhe furnizimin e reparteve partizane në përgjithësi me ushqime e armatime të zëna nga çarmatosja e një pjese të madhe të ushtrisë italiane që kishte kapitulluar në shtator 1943, duke ia dorëzuar të gjitha këto armatime

Brig.II-të S që në këtë kohë ishte në formim e sipër.

Duhet pohuar pa mëdyshje se, ata që mbajtën barrën kryesore të lidhjeve të ngushta të popullit të këtyre krahinave me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i qëndruan besnik deri në fund LANÇ, për krahinën e Çermenikës, Shëngjergjit dhe Martaneshit kanë qenë patriotët e shquar shqiptarë Beg Balla në Orenjë, Ali Shtëpani në Shëngjergj dhe Baba Faja në Martanesh.

Koha, vendi dhe momentet në të cilat u krijua Brig.II-të S

Koha, vendi dhe momentet në të cilat u krijua Brig.II-të S karakterizoheshin nga një numër vështirësish serioze; ishte stinë vjeshte me shira e reshje atmosferike që nuk pushonin; dimri po afronte dhe zona ku grumbulloheshin partizanët që do të hynin në brigadë paraqitej një ndër teritoriet me ekonomi të varfër dhe me klimë të ftohtë, në një terren tepër të thyer malor. Ndërsa nga pikëpamja e situatës ishte pikërisht pragu i Operacionit të madh Armik të Dimrit, të cilin pushtuesit nazistë dhe bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë e kishin përgatitur prej kohësh, duke patur si qëllim që me anë të këtij operacioni të shkatërronin Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe ta shuanin krejt luftën tonë, e cila ishte bërë tmerr për armiqtë dhe shpresë për popullin.

Brigada e II-të S përshkoi një rrugë të lavdishme, të përgjakshme, të mbushur në çdo fazë të Luftës me shembuj vetmohimi dhe akte të heroizmit kolektiv, duke plotësuar gjithmonë me nder detyrat politiko-ushtarake të caktuara nga Shtabi i Përgjithshëm.

Historia e Brigadës së II-të S është historia e luftës dhe e përpjekjeve të atyre bijve dhe bijave që erdhën në gjirin e kësaj njësie nga zonat dhe krahinat e ndryshme të Tiranës, Elbasanit, Mallkastrës, Kurveleshit, Beratit, Korçës, Devollit, Kolonjës etj. Këta bij e bija të thjeshtë të popullit, duke lënë vullnetarisht vendet, vatrën dhe qetësinë familjare, hynë në një familje të madhe partizane, ku luftuan me vetmohim pa kursyer as gjakun dhe jetën e tyre në emër të çështjes të çlirimit të Shqipërisë nga okupatorët nazifashistë. Në këtë luftë të lavdishme ata dhanë kontributin e vet më të çmuar.

Brigada e II-të S luftoi kundër

armiqve të shumtë, si kundër pushtuesve nazifashistë ashtu edhe kundër reaksionit të brendshëm. Ajo veproi në krahina të ndryshme të Shqipërisë të Mesme dhe të Jugut si: në Qarkun e Dibrës së Madhe, në zonën e Matit e të Martaneshit, të Çermenikës, në krahinën e Qarërishtës, të Shëngjergjit, në Zaranikë të Elbasanit, në rajonin e Dajtit, në territorin fushor të Tiranës dhe brenda në kryeqytet, në zonën e Fushë Krujës, të Ishmit, të Pezës, të Darësisë së Peqinit, të Dumresë e Gramshit, të Gorë-Oparit, në rrethin e Përmetit në krahinën e Dangëllisë, të Vithkuqit, në fushën e Korçës e Devollit, në rrethin e Pogradecit, në rajonin e Strugës dhe të Prrenjasit.

Brigada kreu shumë luftime në shkallë njësie, batalioni dhe kompanie

Në gjithë veprimtarinë e vet luftarake, brigada kreu shumë luftime në shkallë njësie, batalioni dhe kompanie. Veprimet luftarake u karakterizuan nga sulme të fuqishme e të vazhdueshme mbi armikun. Në situata nga më të ndërlikuarat, duke vepruar me guxim e trimëri, ajo çau rrethime të ndryshme të armikut si gjatë Operacionit Armik të Dimrit (1943-1944) në Çermenikë, në Pezë, në Brar e Mauri dhe në Operacionin armik të Qershorit 1944 në Dangëlli.

Gjatë mësymjes së përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, Brig.II-të S e ndodhur në drejtimin Juglindor të Shqipërisë luajti një rol të rëndësishëm si forcë goditëse në këtë drejtim për dëmtimin e kolonave gjermane që tërhiqeshin nga Greqia nëpër territorin tonë gjatë rrugëve automobilistike Leskovik-Korçë-Bilisht-Kapshticë dhe Strugë-Qafë Thanë-Librazhd, të cilat ishin të vetmet rrugë të tërheqjes së tyre nëpër Shqipërinë e Jugut. Në Qarkun e Korçës Brig.II-të S zhvilloi një veprimtari të gjerë luftarake. Me formacionet e saj të shtrira gjatë gjithë rrugës automobilistike që nga Leskoviku deri në Kapshticë dhe që nga Struga deri në Prrenjas, ajo mbajti nën goditje të vazhdueshme kolonat armike dhe pikëmbështetjet e tyre të fortifikuara të cilat ishin të vendosura gjatë këtyre rrugëve, duke ju shkakuar atyre dëme të mëdha në njerëz e materiale ushtarake.

Brigada, në bashkëveprim me forcat partizane të batalioneve territoriale asgjësoi përfundimisht reaksionin në krahinat e Kolonjës, Devollit e të Korçës dhe likujdoi në përgjithësi kundërveprimin e tyre të armatosur në këto krahina. Brigada e II-të S çliroi qytetet e Leskovikut e të Ersekës dhe në bashkëveprim me Brig.IX-të S çliroi qytetin e Korçës, një nga



qytetet kryesore të vendit.

Përvoja luftarake e Brigadës së II-të S është me shumë vlerë, sepse burimi prej nga lindi dhe u formua ajo ka qenë jeta dhe rruga e saj e gjatë plot përpjekje e luftë kundra pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ajo luajti rolin që i takonte në kuadrin e përgjithshëm të luftës të UNÇSH e cila dha një kontribut të rëndësishëm për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Nga gjiri i kësaj lufte dolën një plejadë e tërë personalitetesh të spikatura ushtarake e politike, të cilët me pjekuri e vendosmëri, në zjarrin e betejave të ashpra fitimtare kundër pushtuesve të huaj u bënë promotorë të luftës antifashiste të njëjve dhe reparteve partizane që komanduan.

Brigada e II-të S nxori nga gjiri i saj me dhjetra kuadro

Duke vlerësuar LANÇ, natyrisht mendimi shkon tek madhështia e njerëzve që e drejtuan atë. Brigada e II-të S nxori nga gjiri i saj me dhjetra kuadro. Ato ishin njerëz të thjeshtë, bashkëkombas të nderuar, pa përvojën e duhur por me kurajo, patriotizëm e me përgjegjësi qytetare morën mbi supet e tyre një detyrë sa të vështirë, aq edhe të lavdishme, të udhëhoqin luftën e armatosur kundër pushtuesve dhe ta fitojnë atë. Prandaj këto kuadro meritojnë nderim e respekt, por edhe një konsideratë të veçantë.

Brigada e Dytë Sulmuese, që nga krijimi i saj deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë nga pushtuesit e huaj u drejtua nga Beqir Balluku, ish komandant i Brigadës, i cili më pas u bë Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ministër i Mbrojtjes të Republikës të Shqipërisë, ndërkohë që mbajti dhe detyra e funksione të tjera të rëndësishme politike dhe më vonë i pushkatuar padrejtësisht nga diktatori Enver Hoxha.

Komisar Politik i Brigadës ka

qenë Vasil Konomi dhe zv/komisar i Brigadës Kiço Ngjela (ish Ministër i Tregtisë së Brendëshme dhe të Jashtme), më vonë i burgosur politik që mori dënim maksimal dhe familja e tij u persekutua egërisht nga diktatura.

Zëvendës Komandant i Brigadës ka qenë Irakli Bozo dhe Intendent i Brigadës Gani Goxhi, ndërsa përgjegjës i rinisë Alqi Kondi.

Komandantët dhe komisarët e batalioneve në momentin e krijimit të brigadës kanë qenë: Petër Bullati - Komandant dhe Hero i Popullit, Kozma Naska-komisar. Irakli Bozo dhe Bardhyl Mano kanë drejtuar batalionin e dytë si dhe Santo Santo dhe Gazali Sejko, batalionin e tretë.

Brigada e Dytë Sulmuese dha mbi 85 dëshmorë në altarin e lirisë gjatë LANÇ të popullit shqiptar.

Më 28 Nëntor mbushen shtatëdhjet vjet nga dita e krijimit të Brig.II-të S. Populli ynë dhe ne veteranët e LANÇ përulemi me respekt përpara veprës të partizanëve shqiptarë në përgjithësi dhe veçanërisht atyre të Brig.II-të S, të cilët bashkërisht nënshkruan me grykën e pushkës çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit e huaj duke e rreshtuar vendin tonë në krah të koalicionit të madh antifashist botëror që drejtohej nga aleatët e mëdhenj SHBA, BS dhe Britania e Madhe.

Veteranët e LANÇ në përgjithësi e sidomos ata të Brig.II-të S, në këtë përvjetor të 70-të të saj kanë të drejtën të krenohen pasi kanë luftuar dhe përjetuar ngjarje, kanë sakrifikuar duke dhënë vlera për këtë vend. Ndaj ne sot nderojmë veprën dhe sakrificat e tyre dhe përulemi me respekt para kujtimit të dëshmorëve të LANÇ - shokëve tanë me të cilët luftuam bashkërisht në Illogoret e kësaj lufte të shenjtë për çlirimin e Atdheut.

**Veteran i LANÇ, ish kudër i Antifashiste Nacionalçlirimtare Brig.II-të Sulmuese*

Një nga brigadat e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, e cila u inkuadrua në Diviziononin e V-të Sulmues

Brigada e V-të luftoi për çlirimin e Kosovës dhe Sanxhakut

Brigada e V Sulmuese, Heroina e Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë u krijua më 28 nëntor të vitit 1943 në fshatin Gumenicë të Vlorës dhe i përfundoi veprimet e saj luftarake në maj 1945 përtej kufirit shqiptar në tokat e Jugosllavisë.

Historia

Ajo është një nga brigadat e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë, e cila u inkuadrua në Diviziononin e V-të Sulmues pas kalimit në Kosovë më 4 tetor 1944, luftoi edhe për çlirimin e Kosovës dhe Sanxhakut. Përveç luftimeve të ashpra dhe kontributit të pa mat që ka dhënë Brigada e V Sulmuese në trojet e vendit tonë, kjo brigadë ka meritën e vet edhe në çlirimin e Kosovës.

Gjendja politiko-ushtarake

Në përgjithësi në Kosovë ndryshonte në krahasim me Shqipërinë, aty influenconin disa faktorë. Push-tuesit gjermanë, shërbëtorët e tyre kolaboracionistë, si ballistë, çetnikë e ustashtë serbo-malazezë zhvillonin një propagandë që nuk mund të kish asnjë kufi në fshatra e qytete ku banonin vetëm shqiptarë kundër lëvizjes Nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe në Jugosllavi. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre punonin në të dy krahët, edhe demaskonin Luftën Nacionalçlirimtare, edhe hidhnin kundër serbëve që luftonin në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare se qenë armiq të shqiptarëve dhe se kinse luftonin për të çliruar nga shtypja e Serbisë së vjetër. Sipas gjendjes reale që u ndodhën komandat dhe partizanët që në kontaktet e para me popullin e Kosovës u arrit në konkluzionin real se puna e armikut që kish bërë me popullin për shumë kohë, ku shfrytëzonte në maksimum ndjenjat nacionale të shqiptarëve, kish bërë shumë efekt në masën e popullit, që si pasojë kish bërë që shumë nga shqiptarët të ishin vënë në shërbim të okupatorëve, si në trupat e xhandarmërisë e të mercenarëve civilë edhe ata me pagesë. Boshti i punës së armikut kish qenë "se po nuk u bashkuat me pushtuesin, do të mbeteni me Serbinë". Por nga ana tjetër qëndrimi shovinist e shumë armiqësor i njerëzve të Titos, e kishin vënë Kosovën në mes dy zjarreve.

Vazhdimi i genocidit me popullin shqiptar të Kosovës pas lufte, që menduar shumë djallëzisht e poshtërsisht nga ana e udhëheqjes jugosllave pavarësisht se në Konferencën e Bujanit, ku qenë pjesëmarrës edhe të deleguar jugosllavë, ku u vendos që Kosova do të vetëvendoste pas luftës për fatet e saj,

ndaj dhe duhej të luftonte kundër ushtrive pushtuese. Këtë çështje e pengonin jugosllavët, se kishin plane të tjera që nuk diheshin në atë kohë nga udhëheqja shqiptare, ato dolën pas mbarimit të luftës dhe më tej.

Në Kosovë nuk kishte pushtet të këshillave nacionalçlirimtar, këtë nuk e lejonin të dy krahët, as pushtuesi dhe reaksionarët, as udhëheqja jugosllave. Këto që u thanë më lartë janë në vazhden e mendimit se brigadat tona që shkuan në Kosovë për ta çliruar atë dhe vetëm për këtë. Komanda operative planizon operacionin për çlirimin e Kosovës në tri faza kryesore. E para është organizimi e konsolidimi i formacioneve luftarake si dhe formimi i njësisve të reja partizane. Faza e dytë ishte spastrimi dhe mbajtja nën kontroll të plotë të zonave periferike të qyteteve si dhe bllokimi i rrugëve të komunikimit e tërheqjes së trupave gjermane. Faza e tretë do të ishte mësymja e përgjithshme për çlirimin e qyteteve dhe të tërë Kosovës. Me daljen e Brigadës V dhe të I në Kosovë si dhe kalimi i Brigadës së III Sulmuese në zonën e Tropojës, komanda e operacionit e përbërë prej Shefqet Peçit, Fadil Hoxhës e Manush Myftiut, si përfaqësues politike në komandë, u vendosën përkohësisht në Krumë. Në disa zona u morën masa mjaft serioze për shtimin e reparteve partizane nga dy batalionet që ekzistonin. Komanda e Brigadës së 5-të Sulmuese me urdhër të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duhej të dërgonte një numër kuadrosh të zgjedhur e me shumë përvojë në Brigadën e 25-të S, siç kish dërguar më parë edhe në Brigadën e 24-të. Brigada e 5-të dërgoi këta kuadro: Xhevdet Hakami, Veli Kapo, Arqile Milo, Avni Hakani, Harito Çako, Maliq Sadushi, Memdu Tetova, Feim Znelaj, Vitore Imeraj, Thimio Bombaj, Zyber Zyberaj, Aleko Rrapo, Zare Mici, Vojsi Skënderaj, Reiz Dudushi, Halit Xheviti etj. Në fazën e dytë të operacionit u bë spastrimi i zonave periferike të qyteteve që mbaheshin nën kontroll të nazistëve e bashkëpunëtorëve të tyre.

Është interesant fakti që gjatë gjithë asaj kohe që kur forcat shqiptare dolën në Kosovë, u formua edhe komanda operative nga ana e komandës jugosllave, nuk u tregua asnjë lloj interesimi, nuk u kërkua asnjë lloj bashkëpunimi e bashkëveprimi, qoftë edhe operativ në përgjithësi. Kështu forcat tona edhe pse gjendeshin në një territor brenda Jugosllavisë, vepronin nën komandën e udhëheqjes shqiptare. Kjo vazhdoi për dy muaj rresht deri në çlirimin e Kosovës. Luftimet e forcave shqiptare vazhdojnë ditë e



natë pa pushim, ku pati një numër të madh partizanësh të vranë e të plagosur, por kërkohet me çdo kusht çlirimi i Kosovës. Dëshira e partizanëve ishte vazhdimi i luftës pa pushim, ata ishin gjithnjë e më

tepër më superiorë se armiku, kishin dhe popullin me vete, edhe të mashtruarit xhandarë e mercenarë dorëzoheshin për ditë. Kuadrove dhe partizanëve ju mungonte përvoja e luftës në qytet nga të paprit-

urat eventuale. Për luftën në qytet duheshin edhe masa të tjera që duhet t'i merrte çdo komandant dhe, pikë së pari, do të ishte instruktimi i partizanëve e çdo nënrepart të vogël mbi mënyrat e veprimeve.

Integrimi europian si proces mbarëkombëtar

Halil RAMA

Në samitin e partisë popullore europiane, kryetari i partisë demokratike Lulzim Basha u ka kërkuar liderëve europianë të djathtë të mbështesin statusin e kandidatit për Shqipërinë. Sipas Bashës, interesi kombëtar mbizotëron mbi çfarëdolloj mosmarrëveshje të brendshme. Statusi i vendit kandidat jo vetëm që ofron më shumë mbështetje financiare nga BE-ja për Shqipërinë, por ç'është më e rëndësishmja, ai hap rrugën për ndryshimin e vërtetë të vendit përmes negociatave të anëtarësimit.

"Ajo që ishte relevante për mua është prezantimin formal që kryetari i ri në detyrë i PPE dhe kryetari i grupit të PPE në Parlamentin Europian, z. Joseph Daul më bëri para liderëve europianë. Në takimet bilaterale dhe në drekën e punës mu dha mundësia që të flisja për situatën politike në Shqipëri. Kërkova me forcë mbështetjen për statusin kandidat, si diçka që Shqipëria dhe shqiptarët e meritojnë, që vjen pas një progres-raporti objektiv të Komisionit Europian, progres-raport i cili fotografon periudhën e fundit të qeverisjes së koalicionit të PD. Ky pa dyshim është edhe një hap i cili do të ndihmojë në një vëmendje më të madhe të BE, institucioneve të BE dhe vendeve anëtare, ndaj zhvillimeve politike në Shqipëri".

Para disa ditësh, ishte relatori për Shqipërinë në Komisionin e Jashtëm të Parlamentit Evropian, Nikola Vuljaniç, i cili i ka kërkuar Bashkimit



Europian që Shqipërisë t'i jepet Statusi i vendit kandidat.

Sipas lajmit të publikuar nga Zëri i Amerikës, ashtu si dhe raportin e Progresit të paraqitur nga Komisioni Evropian, edhe rezoluta e hartuar nga relatori Vuljaniç, njeh përparimet e bëra nga Shqipëria drejt përmbytjes së objektivave të integritetit dhe vecanërisht arritjen e reformave të kërkuara nga Brukseli, ndërkohë që theksohet se ka ende shumë punë për t'u bërë nga autoritetet shqiptare, veçanërisht në reformën e administratës publike, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pavarësisë së sistemit gjyqësor e pluralizmit të mediave. Sërish theksohet edhe nevoja e dialogut dhe konsensusit mes forcave politike. Duke mbështetur propozimin e Komisionit Evropian rezoluta i bën "thirrje Këshillit të njohë përparimin e Shqipërisë duke i dhënë asaj statusin kandidat".

Përpara se të miratohet nga Ko-

misioni i Jashtëm e më pas nga Parlamenti Evropian, rezolutës mund t'i bëhen amendime nga europdeputetët.

Ndërkohë, Komisioni Evropian hapi më 28 nëntor negociatat me Kosovën për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit pa marrë pëlqimin paraprak të të gjitha vendeve të BE-së, duke përdorur artikulli i 47 i Traktatit të Lisbonës. Në rrugën e procesit drejt integritetit Evropian, hapja e negociatave të MSA-së është hapi më i madh që Kosova ka arritur deri më tani.

Duke e parë integrimin evropian si proces mbarëkombëtar, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL) përshëndet këto dy ngjarje madhore: marrjen nga Shqipëria të statusit të vendit kandidat i BE dhe hapjen nga Komisioni Evropian të negociatave me Kosovën për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

HISTORIA

Me rastin e 101 vjetorit të shpalljes së pavarësië së Shqipërisë

Simboli i pavarësisë së kombit

• Vlorë, qysh më parë ishte përcaktuar si qendër ku do të mbahej Kuvendi gjithëkombëtar për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Në referatin e vet Ismail Qemali foli shkurt për të kaluarën e Shqipërisë, gjendjen dhe rrethanat momentale politike. Ismail Qemali propozoi që Shqipëria të shpallet "Shtet më vete, e lirë, e pavarur. Të gjithë delegatët këtë propozim e aprovuan duke u ngritur në këmbë dhe duke e përcjellë me duartrokitje aktin e shpalljes së pavarësisë.

Valsin TANELLARI

Në çastet më të vështira për popullin shqiptar, kur kërret e Lëvizjes Kombëtare bënin çmos për mbrojtjen e vendit nga copëtimi, vendimtare ishte nisja e Ismail Qemalit nga Stambolli për në Bukuresht. Në historinë e diplomacisë shqiptare shkruhet se Ismail Qemali arriti të përfitonte nga kundërtëheniet ekzistuese të Fuqive të Mëdha. Ismail Qemali, në takimet e fundit që pati me përfaqësuesit diplomatik evropian, arriti të sigurojë simpatinë e idesë së popullit shqiptar për shpalljen e pavarësisë.

Ismail Qemali kërkonte me urgjencë mbledhjen e delegatëve të Shqipërisë në Durrës apo Vlorë. Qemali me 14 patriotë shqiptarë më 19 nëntor u nis nga Trieste, për në Durrës, ku arriti më 21 nëntor 1912. Në rrethanat e rrezikshme politike që ekzistonin në vend nga rryma të ndryshme dhe zënkat e feudalëve shqiptarë, pamundësonin veprimin e lirë në ngritjen e flamurit kombëtar. Në çaste kritike që ekzistonin në Shqipërinë e Mesme, Ismail Qemali me shokë vendosi që të vazhdojë rrugën për nga Vlorë. Në këtë kohë, ushtritë ballkanike kishin hyrë thellë në tokën e Shqipërisë. Ata, tashmë, kishin pushtuar Strugën, Elbasanin, Tiranën dhe ishin nisë për në Durrës, kurse Vlorë mbahej e rrethuar prej grekëve. Qarkullimi nëpër Shqipëri nuk ishte aspak i lehtë, pasi bandat dhe ushtria e shteteve ballkanike kishin zaptuar pjesën më të madhe të vendit. I shoqëruar nga delegatët e disa qyteteve u nis për në Vlorë ku arritën në 25 nëntor. Ky qytet qysh më parë ishte përcaktuar si qendër ku më 28 Nëntor 1912 do të mbahej Kuvendi gjithëkombëtar për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Në referatin e vet foli shkurt për të kaluarën e Shqipërisë, gjendjen dhe rrethanat momentale politike. Ismail Qemali propozoi që Shqipëria të shpallet "Shtet më vete, e lirë, e pavarur. Të gjithë delegatët këtë propozim e aprovuan duke u ngritur në këmbë dhe duke e përcjellë me duartrokitje aktin e shpalljes së pavarësisë. Ismail Qemali e ngriti lart në Vlorën heroike flamurin e Skënderbeut.

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, kryetari i qeverisë së përkohshme, Ismail Qemali, më 29 nëntor 1912, i njofton për aktin historik gjashtë Fuqitë e Mëdha: Anglinë, Italinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë. Po

ashtu, për këtë vendim, Ismail Qemali njofton edhe shtetet ballkanike: Rumaninë, Malin e Zi, Serbinë, Bullgarinë, Greqinë dhe Turqinë, duke kërkuar nga ata që të njohnin aktin e pavarësisë si ndryshim i vullnetit politik të kombit shqiptar.

Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë

Pamja origjinale e procesverbalit të mbajtur n'atë ditë nga Luigj Gurakuqi në bllokun e tij të shenimeve, i fotografuar nga Kel Marubi me 1937 me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë



me cilësinë e fotografit zyrtar i Oborrit Mbretnor. Shënimi i mëposhtëm, i pidentifikuar autori, është bërë për emrat që ishin nga ana e pasme

Deklarata e Pavarësisë e formuluar nga Ismail Qemali dhe e shkruar nga L. Gurakuqi. Kjo paraqitje e dokumentit është një montim nga Lef Nosi me rastin e ekspozitës së 1937, pasi firmat nga M. Kruja e poshtë, tek dokumenti origjinal ishin në pjesën e mbrapme

Më 28 nëntor 1912, në mbledhjen e parë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, u nënshkrua Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë, pjesa shqip hartuar nga Luigj Gurakuqi, dhe pjesa turqisht nga Ismail Qemali dhe e shkruar nga Shefqet Dajiu. Deklarata është dokument i shkurtër dhe i shkruar me dorë, i nënshkruar nga delegatët e Kuvendit, me këtë përmbajtje:

"Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë 1328/1912

Pas fjalëvevet që tha z. Kryetar Ismail Kemal beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zë venduan që Shqipëria më sot të bëhet në vehte, e lirë e e mosvarme".

Perandoria Osmane ra në Luftën e Parë Ballkanike që filloi në tetor të vitit 1912 dhe shqiptarët e gjetën veten në një pozitë tejet të vështirë. Udhëheqësit e tyre ishin më të shqetësuar nga koalicioni i forcave fqinje (Mali i Zi, Serbi dhe Greqi) se sa nga dobësimi i pranisë ushtarake Osmane, në vendin e tyre. Ajo që ata donin ishte ruajtja e integritetit territorial të Shqipërisë. Brenda dy muajve, forcat osmane pothuajse kishin kapitulluar, dhe vetëm në Shkodër dhe Janinë garnizonet turke nuk ishin dorëzuar. Ekzistenca e vendit ishte e rrezikuar.

Në këto rrethana, delegatët nga e gjithë Shqipëria u mbledhën në Kuvendin e Vlorës. Ismail Qemali u kthye në Shqipëri dhe në krye të një asambleje kombëtare prej 83 anëtarësh, shpalli pavarësinë e Shqipërisë në qytetin e Vlorës më 28 nëntor 1912. Në të njëjtën kohë u krijua edhe një qeveri e përkohëshme. Pavarësia e Shqipërisë u njoh më 17 dhjetor 1912 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Delegatët e Asamblesë Kombëtare ishin:

- Berati: Sami Bej Vrioni, Ilias Bej Vrioni, Taq Tutulani, Babë Dud Karbunara (Jorgji Karbunara)
- Çamëria: Veli Gërë, Jakup Veseli, Rexhep Demi, Azis Tahir Ajdonati
- Delvina: Avni Bej Delvina
- Durrësi: Abaz Efendi Çelkupa, Mustafa Agë Hanxhiu, Jahja Ballhysa, Dom Nikollë Kaçorri
- Dibra: Myfti Vehbi Dibra, Sherif Langu
- Elbasani: Lef Nosi, Shefqet Dajiu, Qemal Karaosmani, Dervish bej Biçaku
- Gramsh-Tomoricë: Ismail Qemali Gramshi;
- Gjirokastra: Elmaz Boçe, Veli Harxhi, Myfit Bej Libohova, Petro Poga, Jani Papadhopulli
- Janina: Kristo Meksi, Aristidh Ruci
- Kosova, Gjakova, Plava-Gucija: Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Salih Gjuka, Mit'hat Bej Frashëri, Mehmet Pashë Deralla, Isa Boletini, Riza Bej Gjakova, Hajdin Bej Draga, Dervish Bej Ipeku, Zenel bej Begolli, Qerim Begolli
- Korça: Pandeli Cale, Thanas Floqi, Spiro Ilo
- Kruja: Mustafa Merlika
- Lushnja: Qemal Bej Mullai, Ferit Bej Vokopola, Nebi Efendi Sefa
- Mati: Ahmet Bej Zogolli, Riza Bej Zogolli, Kurt Agë Kadiu
- Ohri dhe Struga: Zyhdi Bej Ohri,



- Dr. H. Myrtezai, Nuri Sojlliu, Hamdi Bej Ohri, Mustafa Baruti, Dervish Hima
- Peqin: Mahmud Efendi Kaziu
 - Përmet: Veli Bej Këlcyra, Syrja Bej Vlorë
 - Pogradeci: Hajdar Blloshmi
 - Tepelena: Feim Bej Mezhgorani
 - Tirana: Abdi Bej Toptani, Murat Bej Toptani, Ymer Sollaku
 - Skrapar: Xhelal Bej Koprencka, Hajredin Bej Cakrani
 - Shijak: Xhemal Deliallisi, Ymer Bej Deliallisi, Ibrahim Efendiu
 - Shkodra: Luigj Gurakuqi
 - Vlorë: Ismail Qemali, Zihni Abaz Kanina, Aristidh Ruci, Qazim Kokoshi, Jani Minga, Eqrem Bej Vlorë
 - Kolonia shqiptare Bukureshtit: Dhimitër Zografi, Dhimitër Mborja, Dhimitër Berati, Dhimitër Ilo

Cungimi i dokumentit të Deklaratës së Pavarësisë

Dokumenti u cungua qëllimisht

nga regjimi komunist, duke larguar disa nga emrat nënshkrues të dokumentit të rëndësishëm.

Kryetarja e Kuvendit i propozoi Presidentit të Republikës dekorimin me urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" të Dom Nikollë Kaçorri, Mid'hat Frashëri, Mustafa Kruja, Iljaz Vrioni, Pandeli Evangjeli, Mehdi Frashëri, Ali Këlcyra, Valon Badivuku dhe Lef Nosi.

Duke u bërë ndoshta një nga shtetet unikalë në botë që kryente një akt të tillë. Dikush nuk shihej me sy të mirë nga regjimi, dikush, sepse ashtu kishte vendosur kupola e lartë e regjimit, apo dikush tjetër thjesht se e ka pasur emrin afër njërit prej atyre që regjimi diktatorial i ardhur mbas vitit 1944, kishte vendosur se ata nuk duhej të ishin pjesë e një prej ngjarjeve më të rëndësishme të këtij kombi, ditës së shpalljes së pavarësisë.



Shënime nga raporti i punës së Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës në periudhën 2012 - 2013

Vehap Shita zgjidhet kryetar i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës

Aktivitetet në shenjë të 70-vjetorit të Konferencës së Bujanit, 100-vjetorit të shtetit shqiptar dhe 5-vjetorit të shpalljes së Kosovës shtet i pavarur e sovran

Kryesia e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, nëpërmjet mbledhjeve të Kryesisë dhe bashkëpunimit me degët e Shoqatës në komuna, e ka zhvilluar veprimtarinë e saj. Kryesia rregullisht i ka mbajtur mbledhjet e veta çdo të mërkurë në formacion më të vogël dhe çdo të dytën mërkurë në formacion të plotë. Sipas nevojës, në mbledhjet të zgjeruara kanë marrë pjesë edhe kryetarët ose përfaqësuesit e degëve në komuna. Në territorin e Republikës së Kosovës funksionojnë degët e SHVLANÇK, të cilat janë aktive: Gjakova, Mitrovica, Gjiçani, Vitia e Peja.

Sivjet, në Prishtinë dhe në qen-

Zoti Krasniqi e ka pranuar me kënaqësi propozimin tonë dhe këto ditë pritet të precizohet agjenda e këtij manifestimi. Presim që në këtë eveniment të marrin pjesë edhe institucione e personalitete nga Republika e Shqipërisë.

Dy ministritë e kulturës - të Kosovës e të Shqipërisë para disa vitesh kanë qenë marrë vesh që me përkujdesje e mjete të Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë të restaurohet ndërtesa Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në Shkodër dhe me mjete të Ministrisë së Kulturës së Kosovës të restaurohet Kulla e Sali Mani në Bujan të Malësisë së Gjakovës, ku është mbajtur Konferenca e Bujanit. Kulla e Sali Mani

2012 në lokalet e Shoqatës së VLANÇ të Kosovës është zbuluar busti i komandantit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës, Fadil Hoxha. Gjatë gjithë veprimtarisë së vet Shoqata jonë kujdes të veçantë i ka kushtuar mbrojtjes së monumenteve të LANÇ të Kosovës, të cilat janë dëmtuar e shumica edhe janë rrënuar. Monumentet e LANÇ të Kosovës janë dëmtuar në dy faza: nga viti 1989-1999 dhe nga viti 1999-2011. Janë rrënuar përmendoret e LANÇK në Podujevë e Vushtrri. Janë dëmtuar: Busti i Hivzi Sylejmanit, Përmendorja e Aradhes Partizane "Zenel Hajdini", Përmendorja e dëshmorëve të LANÇK në Kamenicë.

Lapidari i dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës në Viti. Shoqata jonë ka reaguar duke i dënuar aktet vandale të rrënimt e të dëmtimit të monumenteve të LANÇ të Kosovës në Podujevë, Viti, Vushtrri, Kamenicë, Rahovec, Skenderaj etj.

Ne u jemi drejtuar me shkrim organeve komunale, me kërkesën që të mbrohen monumentet historike të LANÇK, por, kërkesat tona nuk kanë hasur në mirëkuptim tek organet komunale.

Si shembull i mirë për mbrojtjen e monumenteve të LANÇK është Komuna e Drenasit. Lapidari me emra të 43 dëshmorëve të LANÇK



veta në komuna ka organizuar tubime përkujtimore për veprimtarët e dëshmorët e LANÇ të Kosovës dhe për promovimin e librave mbi personalitetet e dëshmorët e LANÇK. Gjithashtu, Shoqata jonë ka zhvilluar një bashkëpunim të mirë me Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Republikës së Shqipërisë. Janë organizuar tubime përkujtimore për: Ramadan Vraniqin, Xhevdet Hamzën, Muharrem Bekteshin, Abdullah Presheven, Bijë Vokshin, Xhafer Vokshin, Vëllezërit Hysni, Musa e Naim Zajmi, Xheladin Hanën e Sait Zatriqinm, si dhe për 70-vjetorin e formimit të Aradhes Partizane "Zenel Hajdini".

Në tubimin përkujtimor me rastin e vdekjes së Xhafer Vokshit i cili u organizua në Gjakovë më 12 dhjetor 2012, fjalën e rastit e paraqiti Vehap Shita, nënkryetar i Kryesisë. Në këtë Tubim folën, Gjeneral Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe Pal Lekaj, kryetar i Komunës së Gjakovës, etj.

Kryesia e SHVLANÇK ka marrë vendim për regjistrimin e të gjitha monumenteve të LANÇK në territorin e Republikës së Kosovës. Regjist-

gjendjen e tyre dhe për masat e mbrojtjes së tyre nga organet kompetente.

Lapidari kushtuar 104 dëshmorëve shqiptarë të LANÇ-ë të pushkatuar nga nazistët gjermanë më 23 tetor 1944 në Prishtinë, pas përfundimit të luftës së fundit më 20 qershor 1999, nga persona të panjohur është dëmtuar. Por me mjetet e Shoqatës dhe me ndihmën e mirëkuptimit të organeve komunale të Prishtinës, të Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport dhe të Ministrisë për Arsim, Shkencë e Teknologji ky objekt është rregulluar duke u inkuorporuar në hapësirën e objektit në ndërtim të Institutit të Historisë në Prishtinë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Qeverisë së Republikës së Kosovës me projektin për Kompleksin memorial "Ibrahim Rugova" parasheh rrethimin e këtij lokacioni me mure betoni. Kundër këtij projekti ka reaguar Shoqata jonë, me kërkesën që memoriali të mos rrethohet por të mirëmbahet nga Komuna e Prishtinës.

Me angazhimin e vendosur kemi realizuar të drejtën pronësore të ndërtesës së Shoqatës së VLANÇ të Kosovës dhe në sajë të këtij vendimi Shoqata jonë filloi të sigurojë mjete financiare pa të cilat s'do të mund të vepronte. Shoqata jonë aktivitetin e vet e ka zhvilluar edhe jashtë Kosovës. Në këtë drejtim, akademik Pajazit Nushi, nënkryetar i Kryesisë, ka marrë pjesë me fjalën përshëndetëse në Akademinë përkujtimore kushtuar Heroit të Popullit Veli Dedi, bir i Luginës së Preshevës në Tiranë më 16.04.2012.

Më 31 maj 2013 ndërroi jetë Vahide Hoxha, kryetare e Shoqatës sonë, e cila ka dhënë një kontribut të çmuar në aktivitetin tonë dhe në afirmimin e degëve të Shoqatës.

Kuvendi i fundit zgjodhi kryetar të Shoqatës Z. Vehap Shita.

Sadri Kabashi,
Sekretar i SHVLANÇK
Prishtinë, 2 tetor 2013



dra komunale e lokalitete të tjera aktivitetet tona janë zhvilluar në shenjë të 70-vjetorit të Konferencës së Bujanit, 100-vjetorit të Shtetit Shqiptar dhe 5-vjetorit të shpalljes së Republikës së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Në shenjë të këtyre jubileve kemi përgatitur dhe kemi botuar librin Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës: KRAH I LUFTËS PËR ÇLIRIM, PAVARËSI, VETËVENDOSJE E SHTETËSI TË KOSOVËSnë vitet 1990-2012 - shënime për monografi nga një grup autorësh.

Për shënimin e 70-vjetrit të Konferencës së Bujanit kemi paraparë të mbahet një tryezë shkencore, për të cilën kemi përgatitur tezat dhe në të cilën parashihet të paraqiten me kumtesa punonjës të shkencës e të kulturës nga Kosova dhe Shqipëria. Kryesia ka formuar këshillin redaktues dhe këshillin organizues të Tryezës. Një delegacion i Kryesisë ka vizituar dy herash kryetarin e Kuvendit të Kosovës, zotin Jakup Krasniqi, dhe i ka ofruar patronazhin e evenimentit me të cilin shënohet 70-vjetori i Konferencës së Bujanit.



është restauruar sivjet, por ende nuk është bërë pajisja me orendi dhe nuk është siguruar mirëmbajtja e saj. Shoqata jonë ka siguruar fotografitë e Kryesisë së Konferencës dhe ka biseduar me organet lokale të Bujanit, të Bajram Currit e të dy Ministrive të Kulturës që të dyja këto objekte të përfundohen dhe të sigurohet mirëmbajtja e tyre si objekte të trashëgimisë sonë kulturore e historike.

Shoqata jonë më 29 qershor ka shënuar 100-vjetorin e formimit të shtetit shqiptar dhe 22-vjetorin e formimit të Shoqatës. Më 25 nëntor

1941-1945 është ndërtuar me gurë të mermerit dhe me interesimin e familjarëve dhe të organeve komunale përmendorja është mbrojtur dhe në një largësi prej 25 metrash është ngritur përmendorja e 104 dëshmorëve të UÇK-së. Përmendorja e ngritur në vendin ku janë varrosur eshtrat e 220 pjesëmarrësve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, që është ngritur në vitin 1960, është rregulluar me mjete tona nga Instituti për Ruajtjen e Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës më 28.12.2012.

Kryesia e Shoqatës me degët e



rimet janë kryer në shumicën e komunave. Pasi të kryhet regjistrimi i të gjitha monumenteve të LANÇK në të gjitha komunat e Kosovës, në fund do të përgatitet raporti për

HISTORIA

Rrëfim interesant i ish-komandantit të Batalionit të Rinisë "Margarita Tutulani"

70 vjet më parë - Si i shpëtuan amerikanët e rrëzuar nga avioni në nëntor të vitit 1943



Nga Skënder MALINDI*

Më 10 nëntor 1943, një avion amerikan që fluturonte mbi qielin e Kuçovës goditet nga artileria kundraajrore gjermane dhe detyrohet të ulet në arat e fshatit Deshiraj, në krahun e djathtë të lumit Devoll, afër Kuçovës. Partizanët që ishin aty afër shkuan me vrap në vendin e uljes së avionit dhe morën gjithë personelin që ishte në avion. Fatmirësisht nuk kishte patur të lënduar gjatë uljes së avionit. Gjermanët mbërritën më vonë atje, pasi lumi Devoll ishte fryrë nga shirat dhe e patën të vështirë për ta kaluar. Partizanët i tërhoqën me shpejtësi 30 amerikanët (15 djem dhe 15 vajza) dhe duke kaluar fshat më fshat arritën në Berat, ku u pritën me shumë dashuri nga populli i këtij qyteti. Ata i mori nën kujdes batalioni partizan "Margarita Tutulani" dhe u vendosën për të pushuar në një vend pranë kazermave të Uznovës, ku ishte vendosur dhe vetë batalioni.

Amerikanët, gjatë gjithë kohës që qëndruan bashkë nuk i kup-

• Me të marrë lajmin për kapitullimin e Italisë, partizanët e Skraparit dhe partizanë të tjerë, me 10 nëntor 1943, me shpejtësi hynë në Berat, çarmatosën ushtrinë italiane dhe morën nën kontroll depot e materialet e ndryshme të kësaj ushtrie. Në këtë mënyrë u siguruan për partizanët mijëra pushkë, mitralozë të lehtë e pistoleta, 90 mitralozë të rëndë, 12 topa, 800 palë çizme, 20 kamiona, 20.000 kuti marmalate e qumesht, 40 kg fasule, sasi të madhe mielli, sheqeri e veshmbathje.

tuam dot përse fluturuan mbi qiellin tonë dhe cili ishte misioni i tyre. Kjo edhe për faktin se nuk e dinim gjuhën e njëri-tjetrit. Gjithshka mbeti enigmë dhe të vërtetën nuk e muarëm vesh kurrë në atë kohë.

Më 15 Nëntor 1943 pa gdhirë, forcat gjermane nga Otlaku dhe Kuçova, në befasi sulmuan Beratin. U zhvilluan luftime të ashpra duke përdorur kryesisht trupat e motorizuara, autobllinda, tanke dhe artileri, të mbështetura fuqimisht nga aviacioni armik. Bashkë me ne ishin edhe partizanët të batalionit "Antonio Gramshi". Forcat tona u tërhoqën nga qyteti i Beratit në drejtim të fshatrave të Nahijes dhe të Skraparit. Bashkë me partizanët u tërhoqën edhe amerikanët për të mos u zënë robër.

Gjermanët vazhduan sulm të fuqishëm deri në Vertop, pasi më tutje drejt Skraparit nuk kishte rrugë automobilistike.

Shtabi i Qarkut të Beratit dhe amerikanët, pasi kaluan Vertopin u futën në një pyll në fund të fshatit Lubesh, por këtu u rrethuan nga ballistët të cilët kërkonin dorëzimin e tyre. Partizanët e batalionit të rinisë "Margarita Tutulani" shkuan menjëherë në ndihmë të tyre, i sulmuan forcat balliste dhe nxorën nga rrethimi shtabin e qarkut bashkë me amerikanët.

Amerikanët të shoqëruar me partizanë u nisën në drejtim të fs-



hatrave të Skraparit, ku ata morën kontakt me oficerët anglezë që ishin pranë shtabit tonë si ndërlihdës me qeverinë angleze. Oficerët anglezë, për çfarë u kishte ndodhur amerikanëve informuan komandën ushtarake të Mesdheut që ndodhej në Itali dhe morën udhëzime prej andej që t'i nisnin ata drejt breg-

detit në rajonin Dhermi-Karaburun, ku do të vinte një anije luftarake angleze për t'i dërguar në Itali. Amerikanët, pasi morën udhëzimet nga oficerët anglezë filluan lëvizjen duke ecur nëpër fshatrat e Skraparit, kaluan në Përmet, Zagori, Mali i Çajupit, nëpër fshatrat e Gjirokastrës për të mbërritur në fshatin Pilur të Himarës dhe prej andej në

bregdet, ku do të takoheshin me një oficer amerikan, që do të vinte enkas nëpërmjet detit për t'i marrë për në Itali.

Në vitin 1995 kur Presidenti Sali Berisha shkoi për një vizitë miqësore në SHBA, e cila u transmetua nga mediat amerikane, një nga ata vajzat e atëherëshme, por që tani ishte e moshuar, me të dëgjuar lajmin shkoi dhe takoi Presidentin Berisha dhe i tregoi gjithë peripecitë që kishte kaluar gjatë Luftës në Shqipëri. Presidenti Berisha e fton atë të vizitojë Shqipërinë, dhe ajo së bashku me vajzën e saj erdhën në vendin tonë. Pas interesimit në Ministrinë e Mbrojtjes mësuam që unë kisha patur kontakt me amerikanët që bënë uljen e detyruar nga avioni në 1943, në kohën e luftës. U takova me ta në hotel "Ballkan" pranë Liqenit Artificial të Tiranës ku ishin akomoduar. Më pritën me përzemërsi dhe biseduam gjerë e gjatë, duke kujtuar atë kohë të vështirë. Ajo më tregoi se çfarë

mbante mend nga rrëzimi i avionit, se si i shpëtuan ne nga gjermanët, pritjen në Berat dhe marshimin e gjatë deri sa mbërritën në Itali. Kur ajo solli në kujtesë pritjen në Berat nga një komandant, djali i ri hypur në një kalë të bukur, mua më erdhi ndërmend se ashtu ka qenë në të vërtetë, se isha unë që kisha hypur në atë kalë të bukur, të cilin e kisha marrë nga regjimenti i kavalerisë që kishim çarmatosur në Berat.

Për të shuar kureshtjen e disa dekadave e pyeta për misionin e amerikanëve që zbarkuan mbi qiellin e Kuçovës atë ditë nëntori të vitit 1943. Ajo më tregoi me hollësi se ata djem e vajza amerikane ishin infermierë dhe punonin në spitalin ushtarak amerikan në Palermo ku mjekonin ushtarakët e plagosur. Por nga luftimet e ashpra në Italinë Qëndrore me gjermanët, kishte pasur shumë të plagosur të



• Me shpejtësi të madhe vijnë në vendin tonë dhe trupat gjermane, të cilat okupojnë Kuçovën, puset e vajgurit e aerodromin. Nazistët gjermanë nisën fortifikimin rreth e rrotull me qendra zjarri dhe me autoblanda. Si duket ata nuk patën ndonjë interes për Beratin, ndaj dhe nuk e okupuan atë, duke qëndruar vetëm në Kuçovë.



tjerë që ishin shtruar në spitalin ushtarak të Barit.Dhe meqënëse shpitali ushtarak i Barit nuk i përballonte dot mjekimet e shumta kishte kërkuar ndihmë nga ai i Palermos.Pikërisht për këtë qëllim ishin nisur ata 30 djem e vajza infermiere me avion nga Palermo për të shkuar në Bari. Por gjatë fluturimit, kur hynë në rajonine Pulias, gjithë vendi ishte mbuluar me re të dendura dhe asgjë nuk shihej poshtë (biles as detin Adriatik nuk e dallonin dot), ndaj dhe pilotët pa dashur fluturan drejt Shqipërisë ku në Kuçovë u goditën nga artileria kudraajrore gjermane dhe u detyruan të ulen.

Amerikania me të bijën, të ndihmuara nga Ministria jonë e Mbrojtjes, shkuan në disa vende ku kishin qenë në kohën luftës si në Berat, Dhërmi e gjetkë, ku u pritën me përzemërsi dhe bënë shumë fotografi.Pasi qëndruan dhjetë ditë

në vendin tonë u larguan nga Shqipëria me kujtimet më të mira.

Ish infermierja, në Amerikë lajmëroi ish kapitenin zbulues amerikan, që i kishte shoqëruar ata nga Shqipëria për t'u kthyer në Itali në ato vite lufte, për vizitën që kishte bërë në Shqipëri dhe për pritjen shumë miqësore që i kishin bërë.Ish kapiteni i zbulimit që tani ishte kolonel kërkoi që edhe ai të vizitonte Shqipërinë.Kërkesa e tij u pranua dhe ai u ftua për të ardhur në vendin tonë. Edhe me kolonelin amerikan pata rastin të takohem unë dhe të bisedoja gjatë me të. Ai më tregoi si kish marrë urdhër nga komanda ushtarake e Mesdheut që të vinte në Shqipëri për të tërhequr amerikanët që ishin rrëzuar me avion atje dhe t'i dërgonte sërish në Itali. Për të zbatuar këtë detyrë - tha ai, u nisa me disa ushtarë si masë mbrojtje dhe me disa radistë për t'u lidhur me oficerët anglezë që ishin pranë Shtabit tonë dhe me

Komandën ushtarake të Mesdheut. Mmë tregoi gjithashtu se si lundruan me një anije luftarake angleze në detin Jon dhe se si zbarkuan natën pa u diktuar në Dhërmi. Aty ishin futur në shtëpinë e një fshatari që i kishte pritur në mënyrë shumë miqësore dhe pasi i kishin kërkuar ndihmë ai ishte treguar i gatshëm për gjithshka ata kishin nevojë.

Koloneli amerikan më tregoi më pas se si e kishte tërhequr pushka e markës "maliher" e varur në murin e dhomës së fshatarit nga Dhërmiu."U bërë kurioz dhe e mora në duar pushkën. Duke lëvizur nëpër dhomë pa dashur shkela këmbëzën dhe pushka plasi, plumbi hapi një vrimë në tavanin prej dërrase",-rrëfente koloneli amerikan të cilit i kishte bërë përshtypje sjellja e të zotit të shtëpisë, i cili nuk ishte merakosur dhe shqetësuar për vrimën në tavan. Bashkëbiseduesi më tregoi gjithashtu për shoqërimin nga i zoti i shtëpisë në drejtim të Pilurit, ku rrugës kishin takuar amerikanët që vinin drejt tyre. Dhe pasi ishin përshëndetur me ta ishin nisur drejt Karaburunit, ku do të mbërrinte anija luftarake angleze për t'i marrë në bordin e saj. "Çdo gjë kaloi pa shqetësim, deri sa mbrritëm në Itali", -tregoi koloneli amerikan, i cili shprehu dëshirën që të shkonte të vizitonte vendet ku kishte kaluar në kohën e luftës. Me mbështetjen e Ministrisë tonë të Mbrojtjes shkoi për të parë edhe shtëpinë ku ishte strehuar atë natë dimri të vitit 1943 dhe u habit kur pa edhe pas kaq shumë vitesh vrimën në tavanin e saj prej dërrase. Ky ishte një kujtim i paharruar dhe i mrekullueshëm për kolonelin amerikan, të cilit iu bë një pritje shumë miqësore. Ai u largua nga Shqipëria me kujtime mbresëlënëse.

MIRNIJE MALINDI - personifikim i sakrificës dhe përkushtimit familjar

Më 15 Tetor 2013, ndërroi jetë Mirmije Malindi, mbas një sëmundje të rëndë që përparoi me ritme të shpejta.

Ajo lindi në Tiranë, më 22 Mars 1933, në gjirin e një familje me prejardhje kosovare. Babai i saj, Avni Zajmi, mbas studimeve të larta në Francë, më 1920 u vendos në Tiranë. I njohur si një patriot i flaktë dhe me një kulturë të gjerë, ai u bë një nga organizatorët e parë të sportit shqiptar të fillim shekullit të kaluar. I nderuar me titullin e lartë "Mësues i Popullit", si dhe një sërë dekoratash, ai është i vetmi shqiptar që i është akorduar "Trofeu Olimpik"nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar.

Mirmija, që në hapat e parë, në shkollë si dhe në të gjitha ciklet e arsimit të saj, tregoi një natyrë studioze me rendiment të lartë. Rezultatet e saj ishin të shkëlqyera dhe me medalje ari.

Ajo kontribuoj në sektorë të ndryshëm, por kryesisht në arsim, ku mbas një stazhi të gjatë dhe të respektuar, doli në pension.

Ajo kishte aftësi të rralla administrative, korrektesë dhe sinqeritet në komunikimin me njerëzit.

Në jetën familjare ishte e përkushtuar, me sens të madh përgjegjësie dhe me një ndjenjë të madhe sakrifice.

Inteligjente, larg sjelljeve mesquine dhe thashethemeve; urrente hipokrizinë dhe lajkat.

Periodha 1974-1991, kur bashkëshorti i saj, Skënder Malindi, u godit rëndë nga Enver Hoxha, duke qenë iurvejuar nga organet e diktaturës, për Mirmijen ishte një sprovë e madhe e jetës.

Familja, megjithëse e braktisur nga miqtë dhe të afërmit tregoi me lidhjen e saj, se ishte më e fortë se lufta klasore dhe terrori i regjimit.

Përtej qënies si bashkëshorte, Mirmija u tregua një shoqe bashkëvetëtare që dinte të lehtësonte depresionin, sidomos kur situata u rëndua me burgosjen e djalit të saj, Ilirit, në Spaç.

Në zemrat dhe mendjen e njerëzve të saj, ajo do të mbetet si personifikim i sakrificës dhe përkushtimit familjar, i shoqes së çiltër dhe korrekte, por mbi të gjitha i njeriut të ndershëm dhe të thjeshtë.

I paharruar qoftë kujtimi i saj!



Rrëfim për masakrën e pashembullt ndaj 104 djemve të pafajshëm

69 vjetori i rënjes të 104 dëshmorëve të Prishtinës

Më kujtohet mjaftë mirë ajo ditë e mallkuar. Ishte data 23 Tetor 1944.Dita sapo kishte filuar të zbardhë. Qielli ishte i ngrysur dhe i mbuluar me re të dendura e të vrenjtura. Dukej se edhe natyra po vajtonte për një fat të hidhur që na priste. Në qiell fillojnë të dëgjohen bubullimat që na tingëllonin thellë në shpirtat tanë, kur paprimtas në qiellin e trazuar dëgjohet një zhurmë. Ngritëm sytë lart dhe në qiell pamë një avion.Ishte avioni "kacator" që mbartëte dokumentacionet e fshehta Tiranë-Prishtinë. Muaj më parë po ky avion kishte sjellë listën e personave që u pushkatuan në Kukës. Të gjithëve na pushtoi frika se mos e njehta tragjedi do të ndodhte edhe me ne.

Komanda menjëherë dha urdhër që gratë dhe vajzat e internuara të

largoheshin nga dhomat e tyre, të cilat ishin ngjitur me kapanonin e burgut të Shkodrës. Mbas dreke, kur të internuarit kishin ardhur nga punët e vështira, bie çanga (zilja e burgut) që na njoftonte për t'u mbledhur. Dalim jashtë duke formuar rreshtat për pesë.U dëgjuan hapat e rëndë të komandantit të kampit dhe vështruan hijen e tij tek afrohej përmes oborrit me një fletushkë në dorë. E kush e mendoi se ajo fletushkë do të ishte kaq e hidhur për neë Ndërsa u pozicionua në krye të rreshtit bashkë me sekretarinë tij, me një ton të lartë dhe të ashpër tha: Kujt t'i dalë emri të kalojë në anën tjetër. Filloi të lexojë kështu një e nga një emrat e disave prej nesh, ndërsa në kamp ra një heshtje varri. Lista ishte e gjatë sikurse u bë edhe rreshti. Leximi vazhdoi deri te nr.104 dhe të gjithë

ata u veçuan për t'i futur në dhomate grave e vajzave, ndërsa ne të mbeturit u kthyem nëpër kapanonet tona. U tmerruam nga zbatimi i këtij skenari famëkeq të hartuar në Tiranë dhe që po zbatohej në Prishtinë. Dalëngadalë ra muzgu i mbrëmjes, ndërsa përpiqeshim të dëgjonim lëvizjet që mund të bënte komanda. Dëgjuam zhurmën e këmbëve të SS-ve duke iu afruar portës së mbyllur. Herë pas here dera çelej e mbyllej duke i marrë dy e nga për pushkatim. Po luhej një masakër e madhe ndaj shokëve tanë.Të ndodhur para kësaj masakre disa nga shokët thyen tavanin dhe hynë në kapanonin e ashtuquajtur shkodran. Pas kësaj komanda lajmëroi se ata që kanë ikur nga dhoma të dalin menjëherë se për ndryshe do na pushkatonin të gjithëve. Asnjë zë nuk u dëgjua, sundonte

vetëm një heshtje e brengosur, dhe urrejtja për kriminelët hitlerianë.

U përdor edhe diversioni duke na paralajmëruar se ai që e ka ngjitur të listuarin ta tregojë se ndryshe do pushkatohet edhe ai. Por askush s'e bëri një gjë të tillë.

Në krahun tim kisha njërin që kishte zbritur nga tavani dhe për të mos u diktuar nga komanda i dhashë kapelen time. Ai nuk dinte çtë bënte por unë i thashë: mos luaj nga vendi se të gjithë kemi të njejtin fat.

-Më mirë të dal para tyre se sa t'ju dëmtoj edhe ju të tjerëve! Kështu tha dhe kështu bëri.Ndërsa komanda e rrëmbeu me egërsi. Me keqardhje them se kurrë nuk ia mësova emrin këtij trimi të vërtetë.

Dua të veçoj dhe një shokun tonë, Xhavit Juknaj, i cili kishte patur dhimbje koke gjatë gjithë natës dhe

nga mungesa e medikamenteve kishite lidhur kokën me një shami që të lehtësonte sadopak dhimbjen. Komandanti i pamëshirshëm i hodhi dritën e elektrikut në fytyrë dhe vërejti disa pika xhaku dhe nga kjo mendoi se ai kishte kaluar tavanin. E mori përkrahësh dhe e nxori para të gjithëve, dhe megjithëse ai thoshte se nuk ishte në listën e atyre që do të pushkatoheshin, nuk iu përgjigj thirrjes së hitlerianëve për të treguar emrat e atyre që kishin ikur nga salla e tmerrit. Xhaviti pranoi më mirë të vdiste se sa të tregonte shokët.

Kjo ishte historia e lavdishme e 104 dëshmorëve ët atdheut. Nga kjo masakër 104 djemve iu mor jeta në lulen e rinisë së tyre.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre.

Sandër LUFÏ

69 vjet më parë

Kronikë nga rruga e lavdishme e Brigadës së 25-të Sulmuese

Nga Hamit NEZIRI

Gjashtëdhjet e nëntë vjet më parë, më 6 Nëntor 1944, me forcat partizane të Malësisë, të cilave u qenë shtuar edhe forca të tjera teritoriale u krijua Brigada e 25-të Sulmuese, e cila u inkuadrua në radhët e Divizionit të 5-të Sulmues dhe mori pjesë në luftimet që zhvilluan forcat tona edhe në tokat e Jugosllavisë, për shpartallimin e plotë të nazistëve gjermanë.

Krijimi i Brigadës 25-të S erdhi si parakusht, pasi në këto treva të alpeve shqiptare, në të gjitha kohërat, çdo pushtues është ndeshur në zjarrin e armëve, duke i bërë të dështojnë të gjitha ekspeditat ushtarake që synuan të pushtojnë e ndëshkojnë malësorët e Tropojës.

Populli dhe partizanët e Malësisë së Tropojës, zhvilluan një luftë të ashpër, jo vetëm kundër pushtuesve fashistë italo-gjermanë dhe tradhëtarëve, por edhe kundër ndërrhyrjes së jugosllavëve. Historia dhe trashëgimia e Malësisë së Tropojës janë shumë herë më fisnike, më të pasura, më të shquara dhe më atdhetare, se sa dhimbjet që koha dhe rrethanat krijuan apo imponuan. Kjo trevë i ka dhënë Shqipërisë personalitete të shquara, atdhetarë dhe politikanë. Veprën e madhe të Mic Sokolit, Ali Ibrës, Bajram Currit dhe patriotëve të tjerë, për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe të bashkuar, e vazhduan me dinjitet brezat e tjerë të trevës së Tropojës, mes të cilëve djali i saj dhe krenaria e Nacionalizmit shqiptar, Udhëheqësi i Studentëve dhe i Lëvizjes demokratike, i paharruari ("NDERI I KOMBIT") AZEM HAJDARI.

Beteja midis vargmaleve të Qafë Kolshit, dhjetra të vrarë e të plagosur dhe mbi 1500 forca armike të kapur robër

Krijimi i Brigadës së 25-të S, më 6 Nëntor 1944 në Tropojën e çliruar, në një terren luftarak të fuqishëm, me një popullsi të gatshme, me pushkë e sopatë në dorë, ishte një ngjarje e shënuar jo vetëm për Malësinë por për gjithë vendin. Kjo brigadë, me komandant Veli Niman Doçin e komisar Nuri Arapin kishin një efektiv rreth 1000 partizanë të inkuadruar në katër batalione që komandoreshin nga quadro të devotshëm, trima, organizatorë, me përvojë të mirë luftarake siç ishin Idriz Mulosmani, Ali Ibrahim Balaj

(Zherka), Mehmet Bajrami dhe Ismail Poga me batalionin e Hasit.

Brigada e 25-të S, e inkuadruar në Divizionin e 5-të S, që në fillim mori detyrën më të rëndë luftarake për t'i ardhur në ndihmë Brigadës së 6-të S që e ndiqte armikun në Malësinë e Shkodrës, drejt Dukagjinit. Komanda e Shtabi morën masa duke marshuar në një terren të largët, malor e të vështirë, në kohë dimri me mbi 1.5 m dëborë, siç ishin zona e Nikaj-Mërturit, Thethi, Shala e Shoshi, duke u ndeshur frontalisht e ballë për ballë me forcat e pushtuesit dhe reaksionarët të ardhur kryesisht nga Shqipëria e Mesme e zonat Verilindore, por dhe me reaksionin vendas që ndiqej nga forcat e shumta partizane. Pra, në kushtet kur armiku ishte superior në forca e mjete luftarake, falë heroizmit partizan, përvojës drejtuese e organizuese të komandës e kuadrove komanduese, u morën masa teknike e pse jo, edhe strategjike për asgjësimin e armikut pjesë-pjesë dhe për sqarimin e popullatës së gënjyer nga reaksioni e paria vendase. Kështu, me sulme e kundërsulme u mundësua tërheqja e forcave reaksionare, duke i vrarë e raskapitur, çarmatosur e demoralizuar, me taktikën për t'i tërhequr e futur në kurtje midis vargmaleve të Qafë Kolshit, mbi 2000 metra të lartë si dhe midis Shkëmbit të Rajës e Lumit të Valbonës që tashmë nga dimri ishte i pakalueshëm. Tani që partizanët luftonin në terren të njohur, armikut iu mbyll "dara" e rrethimit dhe populli, burra e gra luftuan me pushkë, sëpata e hanxharë.

Armiku la në fushën e luftës me dhjetra të vrarë e të plagosur, u zunë rob mbi 1500 veta, që nga komandat e vendit u dërguan atje ku e meritonin. Në këtë situatë u kapën sasi të mëdha armatimi e veshëmbathje të domosdoshme për Brigadën.

Domosdoshmëria që të zbatohej Rezolucioni i Konferencës së Bujanit

Në përfundim të luftimeve midis vargmaleve të Qafë Kolshit, mbi 2000 metra të lartë si dhe midis Shkëmbit të Rajës e Lumit të Valbonës, Brigada e 25-të Sulmuese bëri bilancin e veprimeve luftarake dhe mori detyra për luftime të mëtejshme. Në zonën e Junikut e në përgjithësi Rrafshin e Dukagjinit, që



kufizohen krejtësisht me Tropojën, ku banorët e kësaj treve të lidhur historikisht kanë lidhje gjaku e miqësira, luftimet po zhvilloheshin shumë të ashpra dhe me humbje nga të dyja palët. Në këto kushte u mendua të bëhej një farë armëpushimi, nëse mund të quhet kështu. Për ta qartësuar këtë problem, si parantezë, kërkesa themelore kosovare ishte zbatimi i Rezolucionit të Konferencës së Bujanit, e cila përfundoi më 1 Janar 1944 dhe ku theksohej se "Lufta për çlirimin e Kosovës do të bëhej e përbashkët dhe pas çlirimit, Kosova me popullsi shqiptare në masën 90 % të popullsisë së përgjithshme të saj, me referendum mund t'i bashkohet trojeve amëtare". Për këtë kosovarët kërkonin garanci ngaqë ishin tërësisht të pagarantuar, sepse udhëheqja jugosllave, por edhe ajo shqiptare tashmë i kishin anuluar vendimet e Bujanit. Në këtë situatë, edhe partizanët e kuadrot e Brigadës së 25-të S kishin paqartësitë e tyre, ndaj dhe u zhvilluan bisedime mes shtabit Kosovë-Metohi me shumicë serbo-malazeze dhe drejtuesve shqiptarë. Tashmë u dha urdhër që në skalionin e parë të futet Brigada e 25-të Sulmuese që të mund të evitohet në maksimum vëllavrasja. Vëllavrasja

...Brigada e 25-të Sulmuese vazhdon veprimet luftarake dhe me 28 Nëntor 1944 parakalon fitimtare në Gjakovën e çliruar. Në bashkëpunim me brigadat tjera shqiptare dhe jugosllave vazhdon luftimet për çlirimin e qytetit Ferizaj e rrethinat e tij nga forca të shumta naziste

u mënjana, por u bë e qartë se popullsia shqiptare e Kosovës po binte nën një pushtim shumë më të egër serbo-malazez. Siç e provoi historia 50-vjeçare popullsia kosovare u zhduk, u torturua dhe prej saj emigruan më se një milionë kosovarë në pesë kontinentet e botës.

Marshimi historik, nga Gjakova deri në Vishegrad

...Brigada e 25-të Sulmuese vazhdon veprimet luftarake dhe me 28 Nëntor 1944 parakalon fitimtare në Gjakovën e çliruar. Në bashkëpunim me brigadat tjera shqiptare dhe jugosllave vazhdon luftimet për çlirimin e qytetit Ferizaj e rrethinat e tij nga forca të shumta naziste. Me luftime vazhdon marshimin e saj 20-ditor Ferizaj-Prishtinë-Vuçiternë-Mitrovicë. Gjatë kësaj periudhe iu

bashkuan edhe mbi 350 partizanë kosovarë. Tashmë, në bashkëveprim edhe me brigadat malazeze zhvillohen luftime në qytetet e rrethinat e Novipazarit, Dinicë, Sjudoticë e Strojani. Por luftimet më të ashpra deri trup me trup janë zhvilluar për marrjen e Prijopoljes e deri në Vishegrad.

Për marrjen e lartësive dominuese të maleve të Judovnikut, si parakusht për suksesin e mëtejshëm, heroizmi e trimëria partizane nuk munguan. Të parët në majën e Judovnikut shkelën trimat Ram Bajram Neza e Mehmet Ukë Baçi nga Shipshani. Brigada e 25-të Sulmuese, pasi i kreu heroikisht detyrat e saj luftarake, u kthye në Kosovë, ku gjeti të krijuara njësi të reja të çetnikëve serbo-malazez që gjakosnin, burgosnin e terrorizonin popullin kosovar.

OUPLSH, 22-vjet veprimtari në dobi të profesionalizmit ushtarak



Nga Dhimitër NDRENIKA

Përmbysja e sistemit ekonomik e politik të centralizua, ai i partisë-shtet, rrjedhojë e teorie euforike të mundësisë së barazitizmit shoqëror dhe e veshjes së sistemit faktik feudal të diktaturës së proletarietit me pamje socialiste, krijoi hapësirat e dhura dhe për ushtarakët që të trajtoheshin si qytetarë me kontribute të rëndësishme e të posaçme në mbrojtjen e sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

OUPLSH si Organizata shprehëse e aspiratave të ushtarakëve joaktivë të FA të RSH, pavarësisht nga data e ndërprerjes së karrierës së tyre aktive ushtarake, e themeluar me Urdher nr.119, datë 28.09.1991 të Ministrit të Mbrojtjes, rivërtuar si e tillë me Urdhër nr.133 dt 16.07.1992, po të kësaj ministrie, gëzoi personalitet ligjor në vijësi, dhe sot gezon të drejtën e personit juridik sipas Vendimit nr.2081 dt. 19.09.2007 të Gjykatës së Tiranës.

Organizata bashkoi dhe bashkon të gjithë ushtarakët në pension e të liruar, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, që kanë denoncuar dhe që janë distancuar e shkëputur nga praktikat e regjimit totalitar të partisë-shtet, nga ai i diktatures enveriane, pasojat e së cilës ende nuk janë shëruar. Ajo i qëndron besnike Deklaratës Themeluese të Nentorit 1991, Programeve dhe Statutit të saj të viteve 1991, 1992, 1997 dhe ndryshimeve të v.2006, dhe sot, me përvojën e saj të 22 viteve vazhdon të qëndrojë besnike e synimeve thelbësore të kategorisë së ushtarakëve joaktivë; mbrojtjes kushtetuese e ligjore, ofrimin e përvorjes së saj FA të RSH, lëvrimin e traditës historike të ushtrive shqiptare e sidomos vlerave të larta të UPVNCI e të LANCI, të farkëtuara gjatë provokacioneve të gushtit të v.1949 të monarko-fashistëve grekë e të meritave të anëtarësisë së saj; si pjesëmarrëse në Luftën për clirimin e Kosovës me 1999, si dhe ofrimin të vlerave të ushtrive euroatlantike, ku RSH tashmë e integruar në NATO dhe së shpejti pret të marrë statusin e vendit kandidat në BE.

Kanë kaluar plot 22 vjet nga viti 1991, që nga krijimi i Organizatës së parë, asaj të ushtarakëve në Pension e të Liruar (OUPLSH). Aju u krijua si domosdoshmëri për të mbrojtur të drejtat e liritë themelore të tyre, të mosmohimit të kontributeve dhe mosshndërrimit të tyre

nga profesionistë ushtarakë - oficerë e nënoficerë të dalë në pension si të tillë, në civilë të thjeshtë me trajtim shoqëror e shëndetësor sipas ligjeve për civilët. Dëshmi e këtij trajtimi denigrues e diskriminues është Statusi "famekeq" i ushtarakut të FA të RSH, i 3 Korrikut 1991, i cili u pasua dhe nga ai i v.2004. Këto "statuse", ushtarakët në pension para v.1991 i ndëshkuan kolektivisht sepse ende kjo shtresë sot nuk përfiton si ushtarakët e tjerë.

Edhe ai pension suplementar pleqërie, njohur me ligjet suplementare të v.2005 e deri me 2009, u zvarrit qëllimisht nga tërë qeverisjet, dhe vetëm për 22 vjet përpjekjesh u mundësua përfitimi i pensionit suplementar.

Klasa politike shqiptare i trajton ushtarakët si vegla "për ruajtje, marrje e rimarrje pushteti", koncept ky që edhe Kushtetuta e shpreh vetëm me paanësinë e FA ndaj forcave politike, ndërkohë që nuk iu kufizon partive asnjë diktat apo përdorim për synimet e tyre, duke u shkelur ushtarakëve të drejtat e liritë themelore të tyre. Kjo klasë politike i etiketon ata si "jeshilë nga jashtë e të kuq nga brenda", veçanërisht ata në pension para v.1991, si dhe njëherësh ata ushtarakë që gëzuan statuset e ushtarakut të v.1991 e 2004, që me djallezi iu atribuoi të drejtën e të qenit ushtarakë euroatlantikë, të NATO-s. Kjo klasë politike, me këtë qëndrim vërtetoi më së miri se nuk ka ndryshuar aspak nga konceptet e diktaturës komuniste që i ktheu ushtarakët thjesht në roje të elitës partiake e shtetërore, që i ndëshkoi e i shndërroi në turma pa hierarki e grada, si dhe i burgosi e i vrau si "armiq të partisë e të popullit". Duke i mbetur besnik praktikës së partisë -shtet, kjo klasë politike, sot i jep vetes të drejtë e të qënurit vetëm ajo demokratike, ndërsa ish ushtarakët i trajton si ish mbrojtës të diktaturës.

Organizata jonë, si e para e këtij lloji, ushtarake, në veprimtarinë e saj lufoi dhe u përpoq, e përpigjet që të ndikojë me forcën e saj në trajtimin bashkohor dhe euroatlantik të ushtarakëve, që ata pavarësisht nga data e ndërprerjes së karrierës aktive ushtarake, të gëzojnë "status" me të drejta të barabarta, të diferencuara nga natyra e periudhës së vepritarisë së tyre aktive.

Organizata ka bashkëpunuar dhe do të bashkëpunojë me gjithë aktorët e shoqërisë civile, organizmat shtetërore e qeverisës, e me të tjerë organizma jofitimprures për të mundësuar realizimin e të drejtave legjitime të ushtarakëve në pension e të liruar, joaktivë, vecanërisht të atyre para v.1991.

Ushtarakët në pension pleqërie, para e pas v.1991 si dhe ata në pension të parakohshëm u trajtuan nga shumicat kuvendore, të majta apo të djathta, thjesht si "elektorat", duke shprehur me këtë qëndrim antikushtetushmërinë e tyre, duke ju cënuar bindjet e tyre politike personale, duke cënuar misionin e tyre kushtetues thelbësor për ta, për ru-

ajtjen e tërësisë tokësore, lirisë e pavarësisë së vendit, të mbrojtjes së tij e të rendit kushtetues. Ligjet për depolitizimin e departizimin e ushtarakëve, të pranuar nga kahjet politike u shndërruan në synime për të përfshirë ushtarakët në pension si "shtresë e dhunshme" në duart e tyre. Kjo dëshmohet më së miri nga ngjarjet e v.1997, të atij 1998 e deri tek "mobilizimi" për mosbindje civile për të ardhur në pushtet një parti apo koalicion kundërshtarësh politike. U cënua Kushtetuta në pjesën e saj për ushtarakët, duke iu hequr atyre misionin e mbrojtjes e jo "të veglës" partiake. Kjo është dhe një praktikë e rrezikshme për demokracinë kur politika partiake e quan veten shtet, duke i etiketuar të tjerët si antikombëtare e anasjelltas kundërshtarët si armiq e tradhtarë. Klasa politike nuk duhet të luajë me kombin, popullin, atdheun dhe të ardhmen e vendit, ajo të mos kryejë në asnjë mënyrë veprimtari destabilizuese në dëm të shtetit.

Përpjekjet e Organizatës së Ushtarakëve në Pension e të Liruar të Shqipërisë (OUPLSH) si OJF ushtarake profesioniste, demokratike, e depolitizuar dhe e departizuar, me anëtarësi kryesisht para v.1991, për të mosndarë ushtarakët në breza e për ti trajtuar në barazi me të tjerët nuk dhanë rezultat. Programi dhe synimi ynë për të qenë "ushtarakë me status", "profesionistë", me "gradë" sipas funksioneve që kanë ushtruar pavarësisht nga data e ndërprerjes së karrierës aktive ushtarake, si dhe për të përfituar e gëzuar sigurinë shoqërore suplementare dhe shëndetësore si ushtarakët e tjerë "me status", qoftë të v.1991 apo v.2004, nuk janë marrë parasysh nga asnjë qeverisje, e majtë apo e djathtë. I vetmi përfitim, ai i gezimit të pensionit suplementar të pleqërisë u mundësua vetëm në vitin 2011.

Organizata u ndesh me institucionet e pavarura të shtetit shqiptar, veçanërisht me sistemin gjyqësor, përfshi dhe Gjykatën Kushtetuese, për mohimin dhe trajtimin me standard të dyfishta të kësaj shtrese nga ekzekutivet të majtë e të djathtë.

Organizata u ndesh me koncepte jo profesioniste. Ushtarakët në pension, dashur padashur, më tepër u dhanë pas bindjeve politike që është e drejtë e tyre, në përkrahje e mbështetje të politikave ushtarake partiake, sesa profesionalizmit ushtarak. Deputetë, sih-ushtarakë të të dy krahëve, të majtë dhe të djathtë nuk bënë lobing për profesionin, nuk arritën në një qëndrim konsensual në Kuvend apo nuk shtruan "politika profesionale ushtarake", për të penguar jo vetëm përfitimin e të drejtave kushtetuese por edhe zvarritjen pafund të zbatimit edhe të të drejtave të njohura me ligj për ushtarakët në pension, sidomos para v.1991.

Organizata ka bërë përpjekje të mëdha për kthimin e prestigjit e dinjitetit të ushtarakut, për heqjen

e konceptit enverian "turmë"- me heqjen e gradave me 1996 dhe kthimin në civil me statusin e v.1991 të ushtarakëve joaktive; kundër diskriminimit të tyre e mosvlerësimit të atyre në pension e të liruar para v.1991; kundër ndërrhyrjes së forcave politike, pa mbajtje prej tyre të asnjësisë për shfrytëzim të FA -së për qëllime elektorale, për përdorim si "mish për top" për marrjen e pushtetit nga ato dhe kundër qëndrimeve ekuivoke në emër të demokracisë, për të mos lejuar që shtresat e ushtarakëve joaktivë, sidomos atyre që gezojnë "gradë" të përfshihen në veprimtari të "organizimit", të "pjesëmarrjes" e të nxitjes së mosbindjes civile ndaj autoritetit të shtetit, pavarësisht se cila shumicë kuvendore është në pushtet. Ushtaraket joaktivë me gradë duhet ti binden Kushtetutës, atë cka ajo kërkon: "mbrojtjen e rendit kushtetues".

Në veprimtarinë e saj organizata ka synuar në bashkimin e OJF-ve të ndryshme ushtarake në formë "federate" me sistem rotacional drejtimi dhe të drejtë "vetoje" për veprimtari që nuk përputhen me programin, Akt - themelimin e Statusin e saj. Ajo është kundër shkrirjes në cdo lloj OJF-je ushtarake si mbrojtëse e shtresës më të persektuar të tyre, atyre të para v.1991 (tani moshë e tretë), të mohuar prej atyre të këtij viti, që në vazhdim ndikon në trajtimin e barabartë mes tyre. Njëherësh, organizata ka kryer veprimtari në "bashkime të përkohshme OJF-sh" si për trajtimin e ushtarakëve, për trajtimin e kërkesave të tyre si qytetare, për përkrahjen e mbështetjen e Luftës së Kosovës, për ofrimin e vlerave euroatlantike së bashku me Shoqatën Shqiptare të Atlantikut, si dhe ofrimin "qeverisjeve" të "amendamenteve"për ligjet për ushtarakët dhe të vetë "projekteve" të tyre në vitet 1991-2009 e deri më sot, por që qeverisjet asnjëherë nuk e kanë vlerësuar si "palë" e si "oponencë" në kundërshtim me Kushtetutën.

Organizata kundërshtoi konceptin e realitetit e demokracisë së brishtë shqiptare, të klasës politike të saj, që vodhi e vazhdon të vjedhë "votën" e ushtarakëve në pension. Ligjet, si statutet e ushtarakëve ashtu dhe ato suplementare shoqërore e shëndetësore janë më tepër elektorale, ndërrohen me rotacionin e pushtetit dhe janë antikushtetues sepse diskriminimi kohor i ushtarakëve u jep përfitime të pamërituara shtresave të kufizuara ushtarakësh në pension, qoftë me ligje të veçanta apo të shprehura në ligjet baze, ligje që nuk mbështeten në shpërblimin sipas punës, në moscënimin e të drejtave të njohura e të gëzuara, në ruajtjen e rritjen e mirëqenies dhe jo në uljen e saj e në barazinë para ligjit.

OUPLSH, pavarësisht përpjekjeve të deritanishme, në përputhje me Programin, Akt-Themelimin dhe Statutin e saj, ka bashkëpunuar me të gjitha OJF -të usht-

arake e ato të Veteranëve të LANÇI. Me kënaqësi vërejmë se kemi përkrahjen e mbështetjen e tyre, të tërë shtresës së ushtarakëve në pension para v.1991, të opinionit mbarëkombëtar i cili gjen shprehjen thelbësore në trajtimin tonë si "ushtarakë me status", në përfitime të barabarta me të gjithë ushtarakët e tjerë me "status", qoftë të v.1991 - 2009 e deri më sot. Mirekuptimi ynë është tërësor, pavarësisht bindjeve politike, qënies anëtarë të OJF-ve të ndryshme, si shprehës të vetë opinionit të shtresës së ushtarakëve para v.1991.

Zhvillimet në vend, prirja për stabilitet qeverisës, përmbushja e detyrimeve për marrjen e statusit vend kandidat i BE-së dhe për të avancuar më tej drejt anëtarësisë të plotë në të, kërkon një bashkëpunim më të gjerë e intensiv ndër OJF-të ushtarake. Ka ardhur koha që dallimet të sheshohen në favor të përmbushjes së detyrimeve ndaj ushtarakëve në pension para v.1991 e veteranëve të LANÇI, duke shtuar përpjekjet e përbashkëta në të gjitha kahjet e politikës shqiptare. Synimi është një bashkim federativ apo ndërrshoqator i perkohshëm për probleme të radhes me thelb "profesionalizmin ushtarak".Nuk mund të ushtrohet më genocid ndaj nesh.

Organizata e Ushtarakëve në Pension e të Liruar (OUPLSH) ka dëshmuar e vërteton me veprimtarinë e saj praktike të qenit organizatë profesioniste, që shpreh interesat thelbësore të ushtarakëve joaktivë në pension, pa cënuar, prekur apo kushtëzuar bindjet politike të tyre. Jemi të hapur për bashkëpunim, që shteti shqiptar të konfirmojë se jemi të pavarur dhe se kemi aftësi për të qeverisur në dobi të kombit, popullit, atdheut.

Ka ardhur koha për trajtimin real të ushtarakut në përputhje me standardet e NATO-s e BE, për një rikonceptim të figurës së tij, për një "status" e ligj "sigurimesh shoqërore" e "gradash" gjithëpërfshirës, pavarësisht nga data e ndërprerjes së karrierës aktive ushtarake, vecanërisht për ata të moshës së tretë që përbëjnë numerikisht masën e anëtarësisë së ushtarakëve të para v.1991, atyre të ushtarakëve veteranë të LANCI e të kohës së provokacioneve të gushtit të v.1949 të monarko-fashistëve greke, si dhe të atyre pjesëmarrës në luftën për clirimin e Kosoves të vitit 1999.

Organizata do t'i përmbahet me rreptësi Kushtetutës e ligjeve në fuqi, ndërkohë do të demaskojë me mjete e forma demokratike abuzimet që bëhen ndaj saj; ajo do të luftojë për ritrajtim rrënjësor të anëtarëve të vet, në përjasje me parimet e kriteret e vendeve euroatlantike.

Organizata do të përmbushë në të ardhmen misionet e saj programore, të vlerësimit të kontributeve ushtarake dhe të trajtimit e rivlerësimit nga shteti si "palë" e "oponente", për transparencën e qeverisjes ndaj shtresës së ushtarakëve në pension e të liruar.

Kujtime - 69 vjetori i çlirimit të Tiranës

Beteja për çlirimin e kryeqytetit, 19 ditë luftime të ashpra

Menjëherë filloi pastrimi i qytetit, dhe më 28 Nëntor 1944, para një tribune të improvizuar të veshur me dekor të kuq ku dallohej sigla VFLP, parakaluan forcat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Në fjalimin përshëndetës Enver Hoxha deklaroi se atë ditë u çlirua e gjithë Shqipëria

Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, mbas formimit të Shtabit të Përgjithshëm, mori përmasa të tjera.

Qytete dhe krahina në Jug të Shqipërisë ishin çliruar nga forcat partizane. Okupatori gjerman ishte në tërheqje. Në Tiranë ai instaloi dy bunkerë që kontrollonin: njëri Rugën e Elbasanit, ku më parë ishte xhamija, dhe tjetri tek Shatërvani në qendër të kryeqytetit, që kontrollonte Rugën e Durrësit, të Kavajës, Rugën "28 Nëntori" tek Sahati si dhe bulevardin e madh.

Një autokollonë gjermane ishte rreshtuar përgjatë bulvardit, nga ku ishte ndërtesa e sindikatave deri tek Rruga "Fortuзи".

Si nxënës i Shkollës Principe Di Napoli (sot "Lidhja e Prizrenit") në klasën e pestë, si çdo ditë mora çatën në shpinë dhe nisem drejt shkollës.

Por ç'të shoh?! Asnjë nxënës, oborri i shkollës i zbrazët.

Në afërsi të saj, pikërisht ku Rruga "Isa Boletini" kryeqëzohet me Rugën e Barrikadave ishte ndërtuar një barrikadë nga njësitet e para partizane të ndihmuar nga populli.

-Jorgji, më thotë roja i shkollës:

nuk shikon atje, duke më treguar barrikadën?

U nisa të kthehem për në shtëpi që ndodhej në Rugën "Ded Gjon Luli".

Sapo ra mbrëmja pararoja partizane kaloi bulevardin e madh dhe hyri në rrugën tonë.

Celula e partisë së lagjes mobilizoi me shpejtësi banorët për të dalë dhe ndihmuar për ndërtimin e barrikadës së madhe që lidhte dy anët e bulevardit.

Ne anëtarët e Organizatës "DE-BATIK" të Lagjes 4, pionierë, u mobilizua të drejtuar nga drejtuesit Fiqiri Karrapici së bashku me vëllezërit e tij, Hilmi Karrapici dhe Lutfi, si dhe drejtues Pashko Çomo, Taqo e shumë bashkëmoshatarë të tjerë, duke shfrytëzuar materialet inerte të shëpësisë së Haverikëve që ishte në ndërtim dhe të familjes të nderuar tiranase "Qyqja", që në punishten e tyre prodhonin tuba prej çimentoje për kanalizime. Në kohë rekord, në kushtet e errësirës së natës përfundoi ndërtimi i barrikadës që shërbeu për kalimin e forcave partizane nga krahun i Kinema "Nacional" në krahun e kinema "Rozafat". Ne pionierët, anëtarë të "DEBATIK"-ut të lagjes, që i dinim mirë shtigjet dhamë kontributin tonë duke iu treguar partizanëve rrugët për t'iu dalë pas shpine gjermanëve. Nga shtëpia e vëllezërve "Koja" që ishte në ndërtim u shpua muri ndarës me Hotel "Çajupi" dhe dolën përballë bashkisë. Në fillim par-



tizanët goditën tankun që ishte vendosur pranë C publike që godiste me zjarr Pazarin e Vjetër të Tiranës, i cili digjej. Mbas asgjësimit të tankut, goditjet e partizanëve u përqëndruan drejt ndërtesës së Bashkisë ku kishte forca gjermane së bashku me municionet. Në përfundim të këtij aksioni filloi sulmi drejt bunkerit të fortifikuar, ku u përdor dhe një rul që përdorej për shtrim rrugësh, dhe nga goditjet e fuqishme të partizanëve forcat gjermane u asgjësuan.

Në këto luftime të ashpra morë

pjesë forcat partizane të Brigadave të I-rë, IV-të dhe të V-të Sulmuese. Ndërsa Divizioni i Parë dhe Brigada e XVII-të Sulmuese u përqëndruan në Minierën e Krrabës. Mbas 19 ditë luftimesh të ashpra, më 17 Nëntor 1944 forcat partizane çliruan Tiranën, kryeqytetin e Shqipërisë. Lajmi i çlirimit të Tiranës u përhap me shpejtësi të madhe. Populli doli rrugëve duke derdhur lotë gëzimi, ndërsa partizanët bënin thirrje të bëhej kujdes nga popullata për të mos prekur predhat dhe bombat e paplasura. Me

shpëjtësi morën trupat e ushtarëve gjermanë të vrarë dhe i varrosën përkohësisht pranë ish Kishës Ortodokse të Tiranës që ndodhet pranë bulevardit.

Menjëherë filloi pastrimi i qytetit, dhe më 28 Nëntor 1944, para një tribune të improvizuar të veshur me dekor të kuq ku dallohej sigla VFLP, parakaluan forcat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Në fjalimin përshëndetës Enver Hoxha deklaroi se atë ditë u çlirua e gjithë Shqipëria.

Kronikë e veprimeve luftarake të Brigadës që veproi në zonën e Ersekës, Korçës dhe Bilishtit

69 vjet më parë u përrurua Brigada e 9-të Sulmuese

Më 16 Tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, të gjitha batalionet teritoriale që vepronin në Qarkun e Korçës - "Fuat Babani", "Reshit Çollaku", "Skënder Çaçi", "Tomorri" dhe "Hakmarrja" - u inkuadruan në Brigadën e 9-të Sulmuese. Inagurimi i kësaj brigade u bë në katundin Lozhan.

Qysh në fillim brigada kishte një efektiv prej 1500 partizanësh dhe ish e plotësuar me kuadro, armë e municione.

Edhe eksperiencia luftarake nuk u mungonte partizanëve dhe kuadrove të saj, sepse ata ishin luftëtarë trima dhe të vendosur të atyre batalioneve që kishin pasuruar traditat e tyre në shumë luftime kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve të vendit.

Si zonë veprimi, Brigada e 9-të kishte Ersekën, Korçën dhe Bilishtin. Batalionet e saj më 19 Tetor 1944 muarën në dorëzim sektorët dhe filluan menjëherë nga

veprimet luftarake. Me 21 tetor goditën autokolonat gjermane në Qarr, përqëndrimet e tyre në Dvorr, postabllokun e qytetit të Korçës nga ana e Pogradecit, etj., duke i shkaktuar armikut dëme të mëdha.

Më 22 Tetor "44 forcat e batalionit të parë përsëritën goditjet e tyre kundër postabllokut nga ana e Pogradecit.

Më 23 Tetor batalioni i parë arriti pranë shtabit operativ, që ishte formuar për të drejtuar luftimet për çlirimin e Korçës, për t'u vënë në dispozicion të tij.

Sipas detyrës, batalioni i dytë sulmoi qytetin nga ana e Ravonikut (nga postblloku i rrugës Boboshticë deri në atë të Turanit). Batalioni i tretë vazhdoi rrugën për të arritur objektivin që i ishte caktuar nga komanda e Brigadës.

Më 24 Tetor "44 forcat e batalionit të 4-të të Brigadës së 9-të S prenë rrugën Korçë-Bilisht te Gryka e Cangonjit dhe sulmuan forcat armike që ndodheshin në qytet nga ana e Dishnicës.

Batalioni i 2-të filloi goditjet

kundër postbllokëve dhe në mbrëmje sulmoi qytetin nga ana e Ravonikut. Batalioni i 3-të arriti në objektivin e tij dhe ndau forcat për të sulmuar Bilishtin dhe për të prerë rrugën Bilisht-Greqi. Forcat e batalionit të 3-të hapën zjarr kundër gjermanëve që ndodheshin në Bilisht.

Luftimet në Bilisht vazhduan të ashpra. Gjermanët u përqëndruan vetëm në disa fortifikata, ndërsa në Bilisht hynë forcat tona. Në këtë kohë, batalioni i 4-të, po këtë ditë sulmonte Korçën nga ana e Turanit në rrugën e Pogradecit. Pas luftimesh të ashpra, bashkë me forcat e tjera operative, hyri në qytet.

Më 29 tetor "44 forcat e batalionit të 3-të të Brigadës së 9-të Sulmuese goditën hitlerianët që ishin grumbulluar në rrugën e Follorinës. Në mbrëmjen e kësaj dite partizanët rrethuan katundin Drenovë në kufirin grek. Pas një përpjekje të shkurtër partianët u futën në katund. Në fillim hitlerianët nuk kundërvepruan, pasi kishin qëllim t'u merrnin krahët forcave



partizane dhe t'i asgjësonin. Lufta u ndez e ashpër ndërmjet një pjese të partizanëve që ruante krahët dhe gjermanëve që kërkonin të bënin rrethimin.

Pas dy orë luftimesh, trupat tona u tërhoqën duke lënë të vrarë partizanin trim Xhevat Poloska, i cili mbeti në fushën e nderit, duke sulmuar me guxim për t'i marrë

armikut mitralozin që pengonte lëvizjet e shokëve. Armiku pati humbje në të vrarë e në të plagosur, sidomos në krahun nga sulmoi për t'i rrethuar forcat partizane.

Me tërheqjen e trupave gjermane nga qarku i Korçës, mori fund edhe historia e luftimeve të kësaj brigade të re të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

Fadil Lami jetoi si hero, u dënua si sabotator i mbrojtjes popullore, u shua si një fisnik tiranas

Nga Dukagjin HATA

Ikja nga kjo jetë e njerëzve me botë të pasur shpirtërore, që kanë dhënë për atdheun e kombin djersë, përkushtim e dituri, është e trishtë dhe të lë shijen e një mungese të thellë.

Këtë mungesë ndjeva kur mësova lajmin e ndarjes nga jeta të Fadil Lamit, një tiranas fisnik nga Priska e Madhe, që ishte dhe mbeti etalion i vlerave njerëzore dhe intelektuale. Ai ka qenë një nga figurat kryesore të pushtetit komunist në Tiranë, ku ka shërbyer me përkushtim e devocion, por për shkak se korrnizat e sistemit i rrinin ngushtë fisnikërisë dhe zemërgjërësisë së tij, u ndëshkua nga klanet komuniste të kohës me burg politik, ndërkohë që mbi familjen e tij ra shpata e mallkuar e luftës së klasave...

Sa herë që do të kujtohet rezistenca e Tiranës ndaj urdisë komuniste, do të kujtohet dhe biri I saj Fadil Lami, ky njeri me shpirt të madh e zemër të gjërë, që nuk pyeti për kanunin ideologjik të kohës, por u ngrit kundër gjithçkaje të mykur e të shpëlarë nga maskarda komuniste, në emër të dashurisë së tij për vendlindjen, për Tiranën dhe tiranasit e tij...

Kontaktin e parë me Fadil Lajmin e kam pasur para dhjetë vitesh, kur punoja te një gazetë e përditshme në Tiranë, ku mbuloja rubrikën e dosjerit. Njohja me të, më dha mundësi të hidhja dritë mbi shumë ngajrje e personazhe që patën vepruar në Tiranë, në vitet '70, kur tehu i luftës së klasave ra pa mëshirë jo vetëm mbi elementët e konsideruar antiparti, por dhe mbi vetë lidërshpin komunist të kohës.

Fadili ishte një burrë i urtë, i pasëm, me tipare fytyre të qeshura e të dëlira, jo sikur mbante mbi supe mbi shtatë dekada, por sikur të ishte ende adolishent. Tani që për të duhet të flasim me folje në kohën e shkuar (pasi ai para disa ditësh u nda nga jeta) kujtimi i tij vjen e më bëhet më ngulmues, vepra e tij në një kohë të gjatë pune e përkushtimi atdhetar vjen e qartësohet ende më shumë.

Fadil Lami la gjurmë të bukur në karrierën e tij, të ndërprerë brutalisht nga diktatura komuniste. Ngaqë sistemi punonte në të kundërt të kohës dhe të njerezve, nuk mund të ndodhte ndryshe, nuk mund të ndodhte që Fadil Lami, tiransi shpirtpastër e zemërciltër, që I donte aq shumë njerëzit dhe bënte aq shumë për ta, të mos dënohej, pasi ora e tij punonte në

krahun nga shkonin ëndrrat dhe dashuritë njerëzore...

Ish sekretar i parë i Komitetit të Partisë së Tiranës për Rajonin numër 4, ai ishte gjithmonë i pari në punë e sakrifica, i gatshëm për të prirë gjithmonë me shembullin e tij vetjak. Fadili iu gjendej gjithmonë pranë njerëzve në nevojë, në vend të citateve e direktivave partiake, në vend të fjalëve të bukur, ai kishte si akt qytetarie veprimin, ndjenjën e përgjegjësisë për bashkëtitransit e tij...

Por regjimi donte kukulla të kurdisura dhe jo njerëz të lirë, sic ishte Fadil Lami. Ai kaloi përmes një kalvari vuajtjesh e privimesh në burgjet e Dikaturës, pasi nuk mendonte njësoj si eprorët e tij, të cilët kërkonin ta kthenin Shqipërinë në një bunker gjigand. Fadili nuk iu ra tanbureve të kundërshtimit, por me aktin e tij qytetar, me veprimin dhe mosveprimin si intelektual, padashur u bë pengesë për ata që dyfytirësinë e kishin ngritur në një mënyrë jetese, pasi në fakt dyfytirësia që ngritur në sistem.

Idealizmi i tij si ish luftëtar për liri, kur në samarin e mushkës fuste armë e municion për t'ua çuar partizanëve, puna e tij e madhe me njerëzit, dashuria ndaj njerëzve të thjeshtë të punës, përkushtimi politik e qytetar për të çuar të renë deri në skajet më të largëta të Tiranës, atentatet e forcave të errëta të reaksionit ndaj tij, të cilat për pak i kushtuan jetën, gjithçka që pati bërë për vendin dhe popullin e tij, u fshinë me gomë të zezë nga lidërshpipi komunist dhe për Fadilin u hapën dyert e hetuesive të nxehta dhe burgjeve politike të Dikaturës komuniste.

Fijet e errëta të merimangës nisën të endeshin kur ndaj kuadrove të lartë tirans po projektohej një genocid i përlllogaritur me matematikën djallëzore të një kaste kriminale pushtetarësh. Fill pas vetëvrasjes së shumëlakuar të ish kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, Ndue Marashit, me të cilin e lidhte një miqësi e rrallë, shoqëri e pastër idealistësh, mbi Fadilin nisi projeksioni i përgjimeve, kurtheve e shantazheve të Sigurimit.

"Unë isha viktimë e klanit të Mehmet Shehut kundër tiransave, të cilët ai nuk i kishte me sy të mirë dhe i luftonte me të gjitha mënyrat", më pati rrëfyer kur ishte gjallë Fadili. Një nga një ranë nën tehun e gijotnës komuniste Beqir Balluku, Petrit Dume, Abdyl Këllezi dhe një sërë kuadrosh të lartë të lidërshipt komunist, të gjithë tiranas. Ata ishin udhëheqës



me vizion, njerëz që nuk i bënin kujt keq dhe, në vend të parzmorëve ideologjike të kohës, të titujve e dekoratave diktatoriale, ata mbanin përkujdesjen e njerëzve të thjeshtë, tek të cilët shkonin e vinin pa qibër e bujë dhe ata i rrethonin me mirënjohje e dashuri...

Vetëvrasja e Ndue Marashit ishte strumbullari ku do sigurimi do të thurte fijen helmatisëse të merimangës...

Fadili u akuzua për sabotim të mbrojtjes popullore, gjoja se nuk donte që të bunkerizohej Shqipëria dhe të forcohej mbrojtja socialiste. Një akuzë absurde, por absurditeti ishte aso kohe një mënyrë jetese, një mënyrë e funksionimit të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare!...

Pas dënimit të pamerituar, nisi ora e kalvarit ndaj famuiljes së tij. Djemtë iu nënshtruan sprovave të përjashtimit nga puna, nga shkolla, nga shoqëria. Ai që kishte bërë aq shumë për Tiranën, për rrethinat e saj, ku bridhte në këmbë, duke iu qarë hallin dhe duke ndihmuar hallexhinjtë, tani shihej si "armik" dhe mbi pinjollët e tij Sigurimi projektonte re të zeza sfida të radhës...

I ndjeri Haki Lami, djali i madh i Fadilit, pas burgosjes së të atit mbajti gjallë e me dinjitet familjen, gjersa u shua në Greqi, disa kohë pas fillimeve të demokracisë,

duke rënë në krye të detyrës, teksa punonte si shofer në linjën e autobusave Greqi -Shqipëri.

I ndjeri Arben Lami ka qenë një nga themeluesit e parë të të PD-së në Krrabë e në Tiranë. Në vitin 1989 arrestohet nga policia e Tiranës për motive politike. Së bashku me të vëllanë, Ganiun, marrin pjesë aktive në rrëzimin e bustit të Diktatorit. Ganiu dhe të gjithë vëllezërit e tij janë aktivizuar me sindikatat e minatorëve dhe janë protagonistë të ngjarjeve të vrullshme, që çuan në rënien e dinastisë komuniste, në fillim të vitit 1991. Gam Lami, një sindikalist i vjetër, drejton sindikatat e pavaruara të Tiranës, ku ishte dhe mbeti një personazh aktiv dhe plot passion i jetës sindikaliste.

I vëllai i Fadilit, i ndjeri Rramiz Lami, pati gjithashtu privime së bashku me familjen e tij, hija e luftës së klasave e ndoqi pas si një makth, por ai kurrë nuk e tradhëtoi të vëllanë, Fadilin, i cili mbeti për të dhe për gjithë familjen e farefisin Lami një etalon i drejtësisë, përkushtimit dhe vlerave qytetare.

U shuajt bashkëshortja Xhevria, një grua e dashur dhe e dëlirë, që nuk e uli kurrë kokën, por qëndroi krenare për burrin e saj, për fëmijët e saj, edhe në kohën e sprovave nga më të vështirat

të ferit diktaorial, me cilat u pëballi i shoqi dhe familja Lami, në një kohë të pa kohë.

"Babai im ishte një model se si duhet të jetojë një njeri me nder dhe dinjitet, pa u përkulur për asnjë çast dhe nga asnjë rrethanë", thotë i biri Gani Lami, kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura për Tiranën. Ai dhe vëllezërit e tij e rrethuan të atin për çdo çast të jetës me dashuri e përkushtim, por askush nuk mund t'ia shlyente këtij burri gjurmët e dhimbjes për atë se në vend të nderit e mirënjohjes, ajo kohë e pa kohë i dha si shpërblim vite të gjata burgu, strese e mungesa për familjen e tij, që do ta vuante shumëfish më shumë burgun politik të kryefamiljarit.

Në një përcjellje të tillë nuk mund të thuhet të gjitha, pasi jeta e një njeriu si Fadil Lami, me aq shumë gjurmë në kohë, duhet parë në sa më shumë këndvështrime. Opozicioni i tij me frontin komunist, nuk ishte opozicioni i një kritizieri të fiksuar, por vetëdija e atdhetarit që e kuptonte se nuk mund të vazhdohej më me metoda shterp, me fjalime pompoze dhe "gurë në trastë".

Për pesëdhjetë vjet, ora e kombit punoi në të kundërt të dëshirave të Fadil Lmait dhe atdhetarëve të tjerë, në të kundërt të rrjedhave normale të historisë sonë kombëtare. Por demokracia i vuri pikat mbi "i" dhe vlerësoi kontributet njerëzore, atdhetare e kombëtare, kontribute për të cilat mund të ndihet krenar jo vetëm Fadil Lami, ky fatos i lirisë, jo vetëm familja Lami, por gjithë Priska, Kërraba, Tirana e Shqipëria, për të cilat ai dhe bashkëidealistët e tjerë u bërë pishtarë të gjallë, duke u djegur për të tjerët në errësirën e kohës.

Njerëz si Fadil Lami nuk jetojnë vetëm për vete, nuk jetojnë vetëm për familjen e tyre, ndaj kur largohen nga kjo jetë, ngjallin dhimbje e mungesë jo vetëm tek njerëzit e afërt, tek të dashurit e zemrës, tek ata që e kanë njohur dhe kanë pasur privilegjin ta kenë mik e dashamr, por tek të gjithë ata që kanë dëgjuar për të, për bëmat e këtij burri, që eci gjithmonë një hap para kohës së tij...

Fadil Lami, ky burrë i fortë, jetoi si hero, duke çuar në çdo cep të Tiranës zërin e kohës, u dënua më kot dhe me skenare ogurzinj si sabotator i mbrojtjes popullore, u shua si një fisnik tirans, i rrethuar nga fëmijët, nipërit e mbesat, nga familja e farefisi, miqtë e shokët e shumtë, duke mbetur përjetë një shembull për brezat që do të vijnë...

PER NJE NGA TRASHEGIMTARET E SHTEPISE SE CELES, BASHKELUFTETARE I NGUSHTE I SHEMSO FERIT

ISUF KAMBERI, LUFTETAR I DENJE NE MBROJTJE TE TROJEVE SHQIPTARE TE PLAVES E GUCISE



Nga Ali Demushi*

Krahina apo malesia e Plaves e Gucise siç dihet, shtrihet ne veri te Shqiperise dhe jashte kufirit te saj shtetoror, por e mbetur nen administrimin e shtetit te Malit te Zi. Ajo eshte vendosur ne zemren e alpeve ne nje lugine plot ujera e gjelberim, qendron nen hijen e rende te Bjeshkeve te Namuna, ku poshte tyre vezullon liqeni i Plaves, prej ku rrjedh lumi Lim. Jane ketu dy qytete te vogla, njeri buze liqerit (Plava) dhe tjetri rreze maleve te Bjeshkeve (Gucia) me rrethinat te permendura per bukurite e veçanta si dhe shume vende historike qe deshmojne per qendresen e popullit shqiptar te kesaj treve. Krahina e Plaves e Gucise me bukurite e saj ka qene e mbetet e dashur per shqiptaret por edhe e lakmueshme per armiqtë tane ne çdo kohe, per pozicionin strategjik qe zoteron ajo e cila u sherbente atyre si baze niseje e luftimeve kunder trojeve shqiptare, te Kosoves, Malesise se Gjakoves, Malesise se Madhe deri ne Shkoder e me tej. Me pozicionin qe ka Plava e Guçia, u be per kohen çerdhe e kryengritesve kosovare, zone e terheqjes dhe e ruajtjes se tyre por dhe zone nga niseshin ata per organizimin dhe shperthimin e levizjeve te reja ne Kosove.

Pikorisht per kete pozicion qe ka kjo krahine terhoqi ekspedita ndeshkimore ashtu si Kosova siç ishin ato te Xhavit e Dergut Pashes te cilat dogjen, shkaterruan, vrane e prene por nuk e nenshtruan popullin e kesaj krahine.

Plava e Guçia jane nje krahine e vogel por me nje histori te madhe. Ajo hyri e mbeti ne histori gjate Rilindjes sone Kombetare, ne kulmin e saj ne vitet e lavdishme te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit me 1878. Ajo ishte vatra e pare e qendreses se shqiptareve ne mbrojtje te tokave te tyre dhe e fundit qe u shua me zjarr e hekur. Ai qe kishte Plaven e Gucine ndante fatin e Shqiperise e te Kosoves. Ky ishte vleresimi per kete treve ne ate kohe. Ishin Kongresi i Berlinit 1878 dhe Konferenca e Ambasadoreve ne Londer me 1912-1913 qe bene padrejtesine e pabesine me te madhe ne dem te kombit tone duke e gjymtuar trungun e trojeve shqiptare. Me vendimet qe moren, krahinen e Plaves e Gucise e shkeputen nga trangu i saj dhe ia aneksuan Malit te Zi duke e futur nen thundren sllave. Plava e Guçia u pushtuan por nuk u gjunjezuan. Ne luften per liri, çlirim kombetar e shoqeror dolen e u shquan me dhjetra e qindra luftetar e udheheqes te spro-

vuar qe me veprimtarine e tyre luftarake e diplomatike mahniten kohen ne te cilen jetuan, çuditen çdo starteg e kronist te kohes, i bene sfide shekullit ne te cilen jetuan, i terhoqen vemendjen Evropes plake e te pabese, te regjir me intriga e traktate te fshehta. Trimerine, guximin, mençurine e burrinerine e te cileve populli yne i ruan te gjalla ne telin e çiftelise, lahutes e sharkise, ne ndergjegje e gojedhena, por me shume duhet bere me dokumenta dhe arkiva. Ishin plavianet e gucianet qe me kryetrimin Ali Pashe Guçia, komandantet e strategjet ushtarak popullor, Jakup e Hasan Ferri e deri Shemso Ferri, Ismail Nikoçi, Agon Kaja, e me vone nder te tjere Isuf Kamer Çelaj qe i dolen per zot mbrojtjes se Plaves e Gucise duke u perballur me çdo lloj armiku turk, serbo-malazez, austriak, italian, gjerman apo komunist sipas kohe.

Ne kete menyre kur flitet per Plaven e Gucine patjeter flitet per qendresen heroike te bijve te saj ne lufrat e zhvilluara ne mbrojtje te atdheut si ne Moraçe, Nokshiq, Gerben, ne Luften e Pare e te Dyte Boterore. Siç dihet, ne histori ka mbetur e njohur nje nga betejat me te pergjakshme dhe e para ne shkalle kombetare gjate Lidhjes Shqiptare te Prizrenit, lufta e Nokshiqit ne Dhjetor 1879 - Janar 1880, ku plavianet e hotianet, te komanduar nga Jakup Ferri e te ndihmuara fuqimisht nga trimat e Rugoves, me Sadri Bardhin ne krye, e ne bashkeveprim me afro 2000 forca te Gashit e te Krasniqes, te drejtuara nga Ali Iber Neza e Man Avdia si dhe me forcat e Shkodres me rrethinat te komanduara nga Isuf Sokoli i munden keqas forcat e ushtrise malazeze te Knjaz Nikolles te komanduara nga Mark e Teodor Milani. Luftimet me te pergjakshme ne etapan e fundit zgjaten rreth 4 ore, trup me trup e gryke me gryke, ku nuk bente me pune pushka por shpata e jatagani. Aq shume gjak shkiesh u derdh sa u skuq lumi Lim, ne te cilin u hodhen e u mbyten me dhjetra e qindra malazez, deri edhe pa koke. Humbje te ndjeshme pati edhe ne forcat tone. Ne kete betejë ra heroikisht Komandanti trim i Plaves e Gucise Jakup Ferri, duke mbetur perjete pishtar i pavdekshem i kombit.

Thuhet se Mark milani, kur doli ne pension ne 1900-ten, organizoi nje gosti te madhe ne te cilen kishte ftuar edhe disa krere te Krasniqes te Malsise se Gjakoves, ndoshta per "respekt", por ma shume per ndonje qellim te caktuar, nisur nga gojdhana qe thote se fisi Krasniqe e ka origjinen nga Krasojeviqi, vella i Vasojeviqit te Malit te Zi te ardhur te paret e tyre nga Bosnja. Me kete rast nje kengetar malazez, kendoi nje kenge me lahute, ku i thureshin lavde Mark Milanit, ne betejat e zhvilluara kunder shqiptareve, duke mos zbatuar ne kete menyre normat e mikpritjes ndaj te ftuarve malesore. Mbas lahutarit malazez Sjaq Qerimi (djali e nipi i prijeseve popullor Qerim e Col Delia te Geghysenit te Krasniqes) mori po ate lahute dhe kendoi kengen ne te cilen flitej per humbjet e medha te Mark Milanit, ne lufrat me shqiptaret e sidomos me ata te Plave e Gucise ne Nokshiq, ku nder te tjera thuhet;

Mark Milani, Mark Milica
Jem malsia tan me plisa
Jem me plisa e jatagana
Shih asqerit çka ti bana
N'uje ta mbyta krenat ja ndala.

Ne kete moment atmosfera u acrua aq shume, sepse kjo ishte nje kundervenie e pa pritur, qe tregoi trimerite e popullit shqiptar e per pasojë mund te kalohej ne vrasje e premje ne bese nga njerez te pabese. Ne luften e Nokshiqit nga shtepia e Celes ne Vuthaj, moren pjese me arme ne dore Cele e ukshin Zeneli, At'hëm Kasemi e Dem Feta.

Mbrojtja e Plaves a Gucise shenon nje nga fitoret me te shquara ushtarako-politike te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit per mbrojtjen e territorit, forcimin e unitetit krahinor, besimin ne forcat e veta dhe ngritjen ne nje shkalle me te larte te kerkeses e luftes per autonomi.

Emrat e luftareve te lirise jane te permendur ne dosjet diplomatike evropiane, ne rraportet e konsujve dhe ne planet luftarake te shteteve e ushtrive kundershtrare e armiqesore per kundervenie. Ishte fitorja e Plavianeve e Gucianeve ne luften e Nokshiqit kunder forcave Malazeze te cilave u shkaktuan humbje te konsiderushme. Madheshia e saj shprehet ne vargjet e kenges popullore siç thote kenga: "Mark Milani po ban be / me ksi trimash kurr sjam pre"

Kjo fitore u arrit ne saje te organizimit, drejtimit e komandimit te udheheqesve e komandanteve ushtarak popullor, ndonese prej tyre kishte edhe te pashkolle por qe ishin farketuar me mençurine e Odave te Burrave te Malesise dhe ne zjarrin e luftes per vatan e liri. Çka i beri stratege te nivelit te larte. Ishte fitorja e Nokshiqit qe i detyroi Fuqite e Medha te hiqnin dore nga Plava e Guçia qe ne vend te saj per kompesim i dhane Malit te Zi, Ulqinin.

Priudha 1912-1913 per Plaven dhe Gucine ka qene nder me te rendat qe ka kulmuar me Masakren e Previs me 1913-ten te kryer nga forcat ushtarak malazeze nen komanden e Avro Cemit, ish-komandanti i brigates se Vasojeviqit te poshtem. Ajo ne histori eshte shenuar si konvertimi masiv i myslimanëve shqiptare ne ortodoks sipas planifikimit te kralj Nikolles te Malit te Zi, ku pati rreth 12 500 boshnjake e shqiptare te konvertuar ne ortodoks dhe mbi 800 viktima. Megjithate nuk ia doli me sukses kesaj veprimtarie kriminale te pashoqe.

Periudha ne prag dhe vazhdim te Luftes se Dyte Boterore qe eshte quajtur Koha e Shqiperise 1941-1944 per krahinen e Plaves e Gucise qe me e favorshme ne raport me kohet e meparshme por problemi me i madh ishte lufta me Çetniket e Malit te Zi, ushtrine e saj dhe njesite partizane malazeze te inkuadruara ne te ashtuquajturen Ushtri Nacional Çlirimtare. Ne kete periudhe nje rol te rendesishem per mbrojtjen e Plaves dhe Gucise ka luajtur qeverisja vendore e dy komunave dhe e krahines nga vete shqiptaret me ne krye Hasan e Shemso Ferrin si dhe Sali Nikoçin. Gjithashtu ne kete periudhe rol te rendesishem ne mbrojtjen e krahines kane luajtur shume komandante çetash vullnetare ku nje nder ta ishte dhe Isuf Kamber Çelaj.

Le te shohim se kush ishte Isuf Kamer, nga rridhte e ke perfaqesonte ai ë!

Isuf Kamer Çelaj lindi me 1908-ten ne fshatin Vuthaj te Komunes Plave-Guci. Ishte djali i Kamer Kasemit te Kasem Muzli Çeles. Shtepia e Çeles ne Vuthaj ka qene shtepi e pare, por jo bajraktare, shtepi e pushkes, e beses dhe e bukes qe ka nxjerre trima luftetare te zot ne peri-

udha te ndryshme te historise tone kombetare ne mbrojtje te krahines te Plaves e Gucise. Keshtu fisi (vllaznia) i Çelajve ka bere emer ne histori. Ne te kaluaren por edhe ne ditet e sotme sipas konceptit popullor ne malesite tona te veriut, me fjalën fis eshte kuptuar prejardhja e disa njerezve nga nje At' i perbashket pavaresisht nga largesia e brezave, vendodhja, perkatesia fetare, krahinore, etnike etj. I pari i fisit (vllaznise) vazhdimisht eshte kujtuar me nderim e rrespekt nga pasardhesit e tij per vlerat qe ka patur. Shpesh-here ne trunget gjenealogjike emri i tij perseritej disa here ne breznite per trashegimine e mire e te vyer qe ka lene ai. Prandaj trashegimtarete e denje gjithmone jane perpjekur te ruajne te pastert e te pacenuar figuren e te parit te fisit te tyre.

Keshtu edhe shtepia e Çelajve si vllazni, pati trimat e viktimat e veta qe luftuan e rane ne periudhat e ndryshme te historise qe nga pushtimi osman i Shqiperise, dyndjet sllave, pushtimi austro-hungarez e serbo-malazez, italian e gjerman per mbrojtjen e trojeve Shqiptare. Esh-te per tu permendur Çele Zenel Çelaj qe sebashku me Bali Halilin e Ahmetajve qe u internuan per 3- vjet ne Izmir te Turqise sepse kundershtruan e nuk paguan taksat e vena nga administrata turke. Por te paharruar do te mbeten gjashte bijte e saj qe u pushtuan gjate masakres se Previs sepse nuk pranuan konvertimin ne Ortodoks siç ishin:

Selim Zeneli e Vesel Selimi (Celaj); Meme Osja e Halil Mema (Celaj); Hasan Celja e shume te tjere.

Gjate gjithë kohes djemt e burrat e shtepise se Çeles kane qene objekt masakrash nga forcat Malazeze sepse ata si shpi e si brezni shquheshin per trimeri e guxim duke dale ne balle te luftes me kete armik shekullor pa iu tremb syri sa here e kerkoi nevoja e ketij vedni. Forcen e tyre e shtonin me tej edhe lidhjet miqesore qe kishte shtepia e Çeles me dhenie e marrje bijash ne Malesine e Gjakoves ne Gashe e Krasniqe, ne Kosove ne Rugove e Vermosh, me dyer e familje oxhak, te pare e bajraktare qe shquheshin ne te gjitha kohet per patriotizem e atdhetari qe kur e lypete nevoja me u ndesh me shkjaun, serb apo malazez leshonin kushttrimin dhe pa vonuar u vinin ne ndihme forcat e tyre duke dhene keshtu nje kontribut te madh ne mbrojtjen e Plaves e Gucise. E gjitha keto jane vlera qe shprehin unitetin e bashkeveprimit te nder-sjellte per nje çeshtje te madhe siç ishte çeshtja kombetare. Per t'u permendur keto lidhje me te forta kane qene:

Ne Krasniqe, me BinakAline, Abdyl Qerimin e ZenunAline e Mulosmanajve, me shtepine e Islam Demushit te Geghysenit, me Bajram Hazirin e Rragamit (Kolgeçajve) me Kadri Sokolin e Biberajve etj. Ne Gashe: me Ali Iber Nezen dhe BrahAline e Nezaive. Ne Shipshan me bajraktarin Tahir Beka me shtepine e Rrahman Tanit dhe Hamez Delise dhe shtepine Rrahman Tanit si dhe te Hamez Delise ne Myhejan. Ne Rugove: me Ker Sadrine e Sadri Bardhit. Ne Vermosh: me CalAline (baben e Prek Calit).

Te gjitha keto figura historike te kombit qe permenda me lart ku nipa e ku daje ne raport me shtepine e Çeles kane qene nje baze e shendoshe per te dyja palet ne mbrojtje te çesh-

tjes sone kombetare.

Ne periudha te ndryshme u vrane nga forcat e ushtrise dhe çetniket malazeze disa pjestare nga shtepia e çeles siç kane qene ne 1910 Beqir Dem Celaj 17-vjeç, i vrare ne Shtetiq me 1918-ten, Reko Dem Celaj 15-vjeç i vrare me 5 shqiptare te tjere ne fushen e Brezovices. Me 1910-ten forcat malazeze vrane Bajram Kasem Çelen ne shkalle te Vermoshit, gjate udhetimeit per ne Guci i shoqeruar nga daj i tij Cal Alia (baben e Prek Calit) hakun e te cilit e mori me vone i vellai Kamer Kasemi me shume Vuthjane, Gucijane e Plavjane ne luftime te pergjakshme me ta.

Ne vitin 1920, ne nje pamje ngushelluese per vdekjen e Dervish Demes, i babes se Adem Dervish Celajt ne Vuthaj kishin shkuar per ngushellim nga vllaznia e Selimajve te Valbones vellezerit Shaban e Zenel Breca, Zenel Ahmeti, Rexhep Brahim i Rame At'hemi me shoke. Aty forcat ushtarako-malazeze i arrestuan me pabesi qe te gjithë me dyshimin se ishin komite e organizuar kunder qeverise malazeze, bashke me ata arrestuan edhe Mustaf Arifin dhe Isuf Kamer Celen 12-vjeçar, Hazir Sylen dhe Abdyl Shaban Celen! Pas arrestimit u bene denime me vdekje per Shaban Breçen dhe Zenel Ahmetin e Selimajve te Valbones.

U pushkatua Shaban Breca 70-vjeçar. Zenel Ahmetit ia kthyen denimin me burgim te perjetshem. Disa te tjere u liruan per mungese provash si edhe nga frika e ndonje kundervenie nga popullata e Vuthajve per kete premje ne bese qe iu be kesaj shtepie ne ditën e mortit familjar. Po keshtu ne 1930, vritet tradhetisht Abdyl Shaban Feta (Celaj) ne Osoje, ne qafen e Vranices po nga forcat malazeze me porosi te kapitenit famekeq e mizor Markoviq ku ndaj te cilit ishin ushtruar tortura nga me çnjerezoret per se gjalli e duke e qel-luar me arme per se vdekuri. Gjithashtu çetniket ne 1942 ne muajin maj ne fshatin Pepaj plagosen Brahim Shaban Çelen. Ishin te gjithë keto ngjarje te hidhura ne familjen e Celajve qe per Isuf Kamerin, ku te degjuara e ku te jetuara e rriten dhe e forcuan ate dhe e bene trim e luftetar te pashoq, komandant te çetes vullnetare te Ceremit ne mbrojtje te Plaves e Gucise qe punoi e luftoi perkrah Shemso Ferit, ish-Komandantit te Ushtrise Vullnetare te krahines se Plav-Gucise. Mund te themi se veprimtaria luftarake e Isuf Kamerit me çeten e tij nuk mund te merret e shkeputur nga veprimtaria luftarake e Shemso Ferrit dhe e shume bashke-krahinoreve te tjere, komandanta çetash e luftare te lirise.

Me 6 Prill 1941 kapitullon mbretia e Jugosllavise dhe ne Maj te atij viti nga Shqiperia hyri ne Plave-Guci ushtria italiane. Ne kete kohe qeveria Shqiptare kishte emeruar Riza Ferrin Nenprefekt te Malesise se Plaves e Gucise, nderkohe Shemso Ferri vazhonte detyren e kryetarit te komunes se Plaves qe nga viti 1938.

Ne kete kohe nen drejtimn e Riza Ferrit behet struktura organizative ushtarakë per mbrojtjen e krahines. Formohet shtabi i mbrojtjes per Plave-Guci, shtabet rajonale dhe operative sipas drejtimeve, formacionet e njesive vullnetare te emertuara çeta vullnetare me nga 100



vullnetare per çete. Emerohen komandantet e ktyre çetave nga djemt e burrat me te afte per çeshtjen e mbrojtjes se atdheut. Shtabin kryesor te mbrojtjes e perbente Shemso e Riza Ferri, Ali Bajraktari nga Juniku, Sali Nikoçi etj. Shefi i shtabit u caktua Shemso Ferri nder 15 komandantet e Çetave ishte edhe Isuf kamer Celaj per çeten e Çeremit. Ne fund te ketyre masave u be rregjistrimi i plote i te gjithë vullnetareve luftare te Pave-Gucise. Keto struktura do ushtronin detyren e tyre te pavarura nga ushtria italiane.

Periodha nga viti 1941-1944, eshte quajtur periodha apo koha e Shqiperise per faktin se ne ate kohe u be si te thuash bashkimi i trojeve shqiptare de fakto. Kohe kjo e nje frymemarrjeje me te mire per popullin shqiptar por me te organizuar per mbrojtjen e trojeve tona nga forcat çetnike serbo-malazeze ne zbatim te detyrave qe dilnin nga Lidhja e Dyte e Prizrenit qe drejtohej nga Bedri Pejani . Ne veren e vitit 1941 Shemso e Hasan Ferri dergojne ne Tirane nje delegacion prane qeverise shqiptare per te vendos bashkimin e Plave-Gucise me Shqiperine, çka u ralizua de fakto. Ne perberje te delegacionit prej 7 vetesh ishin: Abdyl Gjonbala, Iber Balidema, Rexh Mazi, Abdyl Qerimi Mulosmanajve, Isuf Balidema, Avdo Avdiqi dhe Isuf Kamer Celaj. Pavarsisht nga pushtuesit fashist e nazist apo nga koha e shkurtër e ketij bashkimi , i rendesishem ishte fakti se filloi te funksionojë kombi siç qarkullon gjaku ne trupin e njeriut duke e ngjall me tej idene e bashkimit ne nje shtet te vetem . Bashkimi i Plav-Gucise dhe i viseve te tjera me Shqiperin vuri ne levizje ne vepër forcë e trupa çetnike dhe te ushtrise malazeze perfshi brigadat e saj partizane me qellim dorezimin apo pushtimin e Plaves e te Guçise.Shemso Ferri si njohes i mire i realitetit gjate kohes qe drejtoi komunen e Plave e me vone te Guçise ndermori disa masa mjaft pozitive çka i rriten autoritetin e respektin e tij ne popull. Ai beri riorganizimin e administrates se komunes ku punesoi shqiptare, boshnjake e malazeze, riorganizoi xhandarmerine , ndertoi nje central elektrik ne Plave , organizoi sherbimin shendetesor, ndertoi kroje per uje te pishem ne qytet, ndertoi e riparoi rruge , futi ne perdorim radio me rryme elektrike, beri furnizimin me mallra te konsumit te gjere , por mbi te gjitha hapi shkolla filllore ne gjuhe shqipe. Ne nje takim qe organizoi ne Korrik 1941 , ku mori mendime per futjen ne perdorim te gjuhes shqipe si gjuhe zyrtare si edhe ne korrespondencen ndermjet komunave i pranishem ishte edhe Isuf Kamer Celaj nje arsimdashës i pashoq.Me kete rast u hap shkollë fillore ne Plave, ne Guci dhe nje paralele e saj ne Vuthaj ku per ket qellim u krijua nje keshill per te hartu program te gjuhes shqipe. Shemso Ferri gjithnji ishte i "preferuari" apo "i pelqyeri" i çetnikeve malazeze te cilet organizuan shume prita per eliminim te tij por me kot. Kudo ku shkonte ai ne takime me perfaqesues malazeze apo mbledhje te ndryshme merite me vete trimin Isuf Kamer Celen , dhe ketu ska asnje dyshim se ai ishte nje nga me te besueshmit e tij qe e siguronte,dhe e ruante nga rreziket. Ne nje takim ne Qershor te viti 1941 me komandantin e çetnikeve te zones Pavle Gjurihiq dhe sekretarin politik te komitetit te qarkut per Beranen (te partise komuniste) Goko Pejkoqiqin , me vete pati ne mbrojtje Isuf Kamer Celen . Aty, Shemso Ferrit i kerkuar qe t'ua dorezonte Plaven e Guçine paqesisht por ai i refuzoi kategorikisht dhe i paralajmëroi se do t'u kundërvihej me çdo kusht me te gjitha forcat e mjetet . Nuk kaloi shume kohe e ne Tetor 1941 emisaret çetnike ia mberrian ne Plave dhe nepermjet komandantit te çetnikeve te Grykes se Lumit, Pavlo Gjurihiq i ben presion psikologjik Shemso Ferrit duke perdor si mjet dergimin e nje pakoje

me gjymtyre femijesh,grash e pleqerish te masakruar nga ata .Para kesaj situuate Shemso Ferri me shtabin e tij te mbrojtjes mori masa per perballimin e sulmit te rreth 2000 forcave çetnike malazeze . U vune ne gadishmeri te gjitha cetat vullnetare te cilat bllokuan rruge dhe drejtime te ndryshme prej ku mund te jepeshin goditje nga armiku . Kryesisht u blloku rruga ne drejtim te Martinajve e Brazovices si dhe hapsira ne drejtim te Vermoshit .Gucine do e mbronin çetat vullnetare nen drejtimin e Sali Nikoçit si komandant i tyre e kryetar i komunes . Rrezistence do beniin rreth 8 çeta vullnetare perfshi çeten e Vuthajve ku bente pjese edhe i riu Sadik Halil Celaj si edhe çeta e çeremit me komandant Isuf Kamer Celen . Me keto masa qe u moren kufiri me Malin e Zi u vendos ne Murine ne drejtim te Lotines qe perfshinte territorin e komunave te Plaves ,Gucise. Me kerkese te Shemso Ferrit e Ali Bajraktarit te Jonikut u be e mundur qe te shkonin ne ndihme te kesaj krahine rreth 1500 - 2000 luftetare nga Peja e Istogu, Deçani e Joniku, Rugova, Gashi e Krasniqja te Malesise se Gjakoves te ardhur nga mbi 15 bajraqe. Keshtu sipas planit u be vendosja e te gjitha forcave per mbrojtjen e Plaves e Guçise por ne drejtimin kryesor te mbrojtjes dhe nga mund te jepej goditja kryesore nga forcat e armikut u vendosen forcat e cetes se Isuf Kamerit per te mbrojtur gjithë hapsiren prane Murines!


Me 31 Tetor 1941 ne ora 10:00 çetniket sulmuan ne tre drejtime .Por menjehere ne mbrojtje kaluan te gjitha forcat. Luftonin Vuthajt e Martinajt, Krusheva e Doli , Vishnjeva e Gerçari ,Plava e Guçia. Ne drejtim te Murines ku armiku dha goditjen kryesore nen drejtimin e Gjurihiqit forcat malazeze paten humbje te medha dhe te zene rob . Ata nuk munden te realizonin qellimin , ndaj u terhoqen nga fronti duke e humbur luften me Shemso Ferrin dhe forcat e tij . Ne kete lufte forcat italiane nuk u perfshine , ata qendruan indiferente. Rajoni i Plaves e Guçise pas kesaj prove te veshtire filloi te marre fryme lirish, tashme ishte pa çetnike, u vendos paqja , rendi e siguria nga xhandarmeria .

Ne keto luftmie Shemso Ferri nuk pranoi te bashkepunonte me partizanet shqiptare sepse ata ishin te lidhur me partizanet malazeze e kishin formura celula te partise komuniste ne Plave e ne Guci dhe kercnonin me vrasje udheheqesit e kesaj treve . Ne kete kohe ishte formuar edhe Aradha e Plaves dhe Guçise qe perbehej nga komuniste te kesaj zone . Ne vitin 1942 ne Plave kishte qetes por edhe gadishmeri per kundervenie ndaj sulmeve eventuale qe mund te vinin nga cdo ane prej çetnikeve . Lulezoi tregtia me Kosoven, Shkodren e Tiranen ,çka ndihmoi ne zhvildhimin e vendit. Ne gjysmen e pare te 1942, Shemso Ferri u emerua kryetar i komunes se Guçise dhe Sali Nikoçi kryetar i komunes se Plaves qe nga fundi i vitit 1942 u be perseri nderrimi i detyrave te tyre ne keto komuna . Ne Guci Shemsi ndoqi te njejeten praktike si ne komunën e Plaves duke e ristrukturuar ate. Vendosi mardhenie te mira me kreret e Vuthajve veçanerisht me Celajt, Ulajt e Qosajt. Keshtu u hoq edhe kufiri me Shqiperine .

Ne fillim te Qershorit 1943 Shemso Ferri konfliktohet me komandantin e ushtrise Italiane Fajkon. Ndiqej prej tij per t'u arrestuar dhe familja e tij per t'u internuar por gjeti strehim ne Vuthaj ne familjen e Celajve e sidomos ne Cerem ne Markovçen e Celes. Ndaj ketyre veprimeve Shemsi e kercenooi Fajkoin me ane te nje leter per qendrimin qe mbante .

Ne fillim te Gushtit 1943 ai merr masa sigurie per familjen e tij duke e zhvendosur ate nga zona e rrezikshme .

Me 9 Shtator 1943 kapitulloi Italia fashiste , Shemsi me luftetaret e tij hyne ne Plave pasi kishte qendruar ne Markovçen e Celes per rreth 2 jave tek Isuf Kameri per efekt sigurie dhe men-



jehere mori ne dore drejtimin e komunes . Pas kthimit ne Plave Shemsi u zgjodh Nenprefekt i Plaves dhe i Guçise. Ne kete kohe partizanet malazeze mesyne per te hyre ne Plave e ne Guci por populli i kundërshtoi me zjarrin e armeve.

Pas pushtimit nazist gjerman te vendit ne 1943-44, gjendja ne Plave e Guci u rendua shume . Çetniket bene marreveshje me gjermanet dhe kercenuan shqiptaret e kesaj treve me vrasje ,djegje e shkaterrime duke i konsideruar te gjithë kriminele qe do ti mbysnin ne çdo hap.

Ne kete kohe ne ndihme te vellezerve Plavianë e Guçiane (me17 Tetor 1943 nje pjese e batalionit partizane "B.Curri" i Malesise se Gjakoves shkoi ne Plave e ne Guci po keshtu me vone edhe batalioni partizan "Perlat Rexhepi " i Shkodres . Ne takimin qe beri Shemso Ferri te Krojet e Ali Pashe Guçise me udheheqjen e ketyre forcave siç ishin Mehmet e Fadil Hoxha, Veli Niman Doçi komandanti i Br 25 partizane , Sali Manin bajraktar i Krasniqes me te birin Jahon; te pranishem veç te tjereve pati Isuf Kamer Celen. Ata i kerkuar Shemso Ferrit qe t'i lejonte per te vepruar ne Plave e Guci por Shemsi pasi i pyeti se :

" A jeni ju te zotet qe kur te vijne gjermanet me çetniket malazeze se bashku , te na mbronin ne edhe popullinë", u pa nje fare lekundje nga ana e tyre per shkak te bashkpunimit me brigadat partizane malazeze e megjithate Shemsi i lejoi te qendrojnë ne Vuthaj ne shtepine e Sadik Bekteshit ku kaluan dimrin e vitit 1943. Pas kthimit te forcave shqiptare ne Malesine e Gjakoves dhe angazhimit te tyre ne luftime me gjermanet ne vitin 1944 , aty nga fundi i ketij viti udheheqja e ketyre forcave i beri thirrje Shemso Ferrit qe te bashkohej me ta duke i premtuar ne rast fitorje nga ana e tyre detyren e komandantit per Plaven e Guçine. Kete kerkese Shemso Ferri e hodhi poshte duke mbajtur qendrim te prere ku ishte shprehur :

" kurre nuk behem me komunistet, dua te vdes ketu, si te paret e mij , nuk dua ti tradhetoj ata duke u bashkuar me komunistet".

Ne fund te vitit 1943 e Janar-Shkurt 1944 Aradha partizane e Komit e kthyer ne brigade, sulmoi

xhamine e Pepajve por ketu forcat e Shemso Ferrit bene rrezistence te fuqishme duke kaluar ne kundërsulm me pese çeta vullnetare ku ne kete beteje duke luftuar me trimeri te pashoqe me çeten e tij ra heroikisht Isuf Kamer Celaj, ne ndjekjen kembakembes te armikut ne thellesi te territorit .Me renien e Isufit çeten e mori vete Shemsoja per te vazhduar luftimet e metejshe por , forcat partizane çetnike malazeze u terhoqen ne drejtim te Lotines e Andrejvices duke pesuar humbje te ndjeshme .Eshte per tu theksuar fakti i respektit i dashurise dhe simpatise se luftetarit Sali Rama nga Selimajt e Valbones per komandantin ,bashkeluftetarin e tij, Isuf kamerin edhe ne ditën e renies , i cili ishte shprehur "Me e pas ditur se kur e merr pushka Isuf Kamerin

Isha ba kmishe e tij , me vdek bashke me te "

I ndodhur ne keto shtate Shemso Ferri beri nje takim ne Vuthaj me disa nacionaliste si Zenun Alia e Abdyl Qerimi te Mulosmanajve te Krasniqes si edhe disa antikomuniste te tjere per ti bere rezistence rrezikut komunist qe i kercenonte gjithnje me shume .

Situata sa vinte behej me e vesh-tire e ne keto kushte ishin Adem Derwish Celaj e Pulec Hima i Ahmetajve qe siguruan levizjen e tyre per takim me Sali Nikoçin ne Doli ,ku kordinuan veprimet e perbashketa ne mbrojtje te Plaves e Guçise , por aty u rrethuan nga forcat partizane ku mbeti i vrare Muj Bajrami i Geghy-senit vet i dyte. Pas daljes nga rrethimit Shemso Ferri bashkoi forcat e tij me Prek Calin e Vermoshit i cili ishte nje antikomunist i vendosur .

Situatat qe u krijuan ia vesh-tire-suan qendrimiin e metejshe me ate zones dhe per efekt sigurie e perfitimi ne kohe per organizim e veprime te metejshe me forcat e tij shkoi ne Shkoder. Ne fshatin Repisht te Malesise se Madhe u strehua ne nje shpelle bashke me vellain e tij Hamdine.Nuk vonoi shume dhe e rrethuan forcat partizane shqiptare te cilat i kerkuar qe te dorezohej .Ai iu pergjigj atyre se "une kurre nuk kam luftuar kunder shqiptareve , perballe gjithmone kam patur shkiet dhe partizane e çetnike malazeze ". Per te mos u dorezuar i gjalle vet-

AKADEMI PERKUJTIMORE NE PLAVE

KESHILLI ORGANIZATIV I SHOQATES "ALPET SHQIPTARE NE PLAVE E GUCI NE BASHKEPUNIM ME FAMILJEN ,ORGANIZOI PARA DISA KOHESH NE FSHATIN VUTHAJ TE KOMUNEZ GUCI NE MAL TE ZI,ZBULIMIN E PLLAKES PERKUJTIMORE PER DESHMORIN E KOMBIT ISUF KAMER CELAJ , I RENE NE JANAR 1944, NE MBROJTJE TE KUFIRIT TE SHQIPERISE NE MALESINE E PLAVE-GUCISE NGA FORCAT CETNIKE MALAZEZE. ME KETE RAST U MBAJT NJE AKADEMI PERKUJTIMORE NE SHTEPINE E KULTURES NE PLAVE ME PJESEMARRJEN E 2000 VETEVE ,KU PER JETEN DHE VEPRIMTARINE LUFT-ARAKE TE ISUF KAMERIT NE MBROJTJE TE TROJEVE SHQIPETARE LIGJERUAN:

Profesor Marenglen Verli nga Tirana, ushtaraku ne pencion Ali Demushi nga Shkodra. Pershendeten me kete rast, Drejtori i Institutit te Historise se Shqiperise Beqir Meta, deputeti i Tropojes Besnik Dushaj dhe poeti Hamit Alia. Aktiviteti u shoqerua me nje program te larmishem artistik me kenge e valle per Isuf Kamerin te kenduara nga Gezim Nika dhe te interpretuara nga Deli Metalija me grupin , me kompozim te Edmond Zhulalit nen drejtimin e modera-tores Shpres Uckamaj .

Ne perfundim, ne emer te familjes dhe farefisit te Celajve pershendeti pjesemarrësit Isuf Zenel Celaj , kuader i larte ne Minis-trine e Brendeshme te Shqiperise .

Aktiviteti u mbyll me shtrimin e nje darke ne qytetin e Plaves!

evritet sepse e kuptonte se ne rast dorezimi do te perfundonte te forcat partizane e çetnike malazeze ku e priste vdekja e sigurt.

Isuf Kameri e Shemso Ferri rane ne fushen e luftes e te betejes , ne fushen e nderit ku bien burrat ne mbrojtje te trojeve shqiptare te Plaves e Guçise. Fatkeqesisht koha nuk ia mberriti qe t'a shikonin Plaven e Guçine te bashkuar me Shqiperine. Ajo mbeti atehere e deri me sot nen Malin e Zi. Sot me nje ndryshim,qe shqiptaret ne Mal te zi si ne Plave e ne Guci , Ulqin , Tuz e Tivar pas sh-keputjes se Malit te Zi nga Serbia dhe perfshirjes se saj ne proceset demokratike kane fituar mjaft te drej-ta si pakica mbi bazen e normave nderkombetare por perpjekjet e tyre do te jene ne vazhdimesi per nje bashkim kombetar ne nji Shqiperi etnike.

Populli nuk vdes kurre, nuk i har-on bijt e tij per veprat qe kane kry-er. Kombi eshte i pavdekshem, bijt e tij qe flijuan jeten per atdhe i ve ne vend te nderit ne kujtesen dhe histo-rine e tij. Prandaj dhe ne sot ne kete Akademi te organizuar ketu , ne Malesine e Plaves e Guçise perkuj-tojme me nderim e respekt renien heroike te Trimit te shtepise se Ce-les, Isuf Kamer Celes ne 105-vjetor-in e lindjes e 69-vjetorin e vrasjes ne moshen 36-vjeçare nga forcat çet-niko-malazeze. Kjo akademi perkuj-timore me vendosjen e Permendores se tij ne vendlindjen Vuthaj le te sher-beje si thirrje per te mos harruar te shkuaren qe te mos na perseritet ne te ardhmen , dhe si nje akt human per tu njohur nga brezat qe do vijne.

I perjetshem qofte kujtimi i Tij!
***Nenkolonel i ushtrise shqiptare ne pension)**
Mbajtur ne Plave me 29.07.2013

SIMPOZIUM PËR PETRO MARKON NË KRAJOVA TË RUMANISË

100 vjetori i lindjes së shkrimtarit Petro Marko ishte motivi i organizimit të simpoziumit "Petro Marko dhe letërsia bashkëkohore shqiptare", në kryeqendrën e krahinës së Oltenisë, në Krajova të Rumanisë. Simpoziumi iu kushtua jetës dhe veprës së autorit shqiptar, rast me të cilin u bë edhe promovimi i librit në prozë "Njerëz dhe ujër" të Petro Markos, i përkthyer në rumanisht nga përkthyesi i mirënjohur dhe njohësi i letërsisë shqipe, Marius Dobresku.

Midis të tjerash, Dobresku tha: "Shorti i këtij shkrimtari të talentuar

ilustron më së miri karakterin vrasës të komunizmit shqiptar, të komunizmit në përgjithësi: gjithmonë dhe kudo, regjimi likuidoi në radhë të parë fëmijët e vet, ata idealistë që mendonin se ëndrra për një shoqëri më të mirë mund të bëhet realitet. Shqipëria është një shembull domethënës në këtë kuptim: duke filluar nga shokët e luftës antifashiste, e duke përfunduar me kryeministrin Mehmet Shehu, Enver Hoxha likuidoi një brez të çmuar pjesëmarrësish në luftën antifashiste, intelektualë, shkrimtarë etj. Petro Marko ishte një nga viktimat".

Shkrimtari dhe përkthyesi Marius Dobresku, gjithashtu, u foli të pranishmëve për peripecitë dhe dramën e shkrimtarit Petro Marko, për ngjitje-zbritjet, për sukseset e shënuara, por dhe dështimet e dhimbshme, duke lënë nga pas "veprën e tij jetëgjatë, që tejkaloi qartazi peizazhin letrar të kohës. Është një vepër e cila, me siguri, do të mbetet në vite, si dëshmi e talentit dhe forcës shprehëse të këtij krijuesi të denjë".

Që në fillim të daljes në dritë, tregimet e Petro Markos gjetën vlerësimin e lexuesit rumun, ashtu sikundër edhe autorë të



tjerë shqiptarë në zë, të përkthyer nga Marius Dobresku si Ramiz Gjini, Arber Ahmetaj, Fahri Balliu, Gjekë Marinaj, Ermir Nika etj. kanë zgjuar vazhdimisht interesin e këtij lexuesi.

Në kumtesën e tij, studiuesi i letërsisë, Dr. Luan Topçiu, u shpreh se: Duke qënë një nga pjesëmarrësit në Luftën Civile të Spanjës (1936-1939), duke pasur kontakte të drejtpërdrejta me letërsitë dhe gjuhët perëndimore, Petro Marko ka qënë i markuar me frymën e kohës dhe nga

disa modele kulturore europiane, që kanë pasur një short të ngjashëm. Ishte pikërisht kjo frymë perëndimore që nuk u tolerua nga komunizmi shqiptar, i cili, nuk fali as veprën e tij, por as vetë shkrimtarin. Në një radhë tjetër idesh ai u shpre se: "Marko hapi ulli të reja në prozën shqiptare, prozë e asfiksuar nga metoda zyrtare e realizmit socialist, duke i thyer normat e kësaj metode, me fuqinë e fjalës, me lirizmin e tij, me frymëmarrjen e lirisë, që e bëjnë prozën e tij të pëlqyer dhe të lexueshëm dhe sot e gjithë ditën."

Në këtë aktivitet, kushtuar kujtimit të Petro Markos, organizuar nën patronazhin e shoqatës Lidhja e

Shqiptarëve të Rumanisë, morën pjesë deputetja Oana Manolescu si dhe një audiencë e interesuar e përbërë nga shkrimtarë, njërez të kulturës, gazetarë etj. Aktiviteti u ndoq me interes nga të pranishmit, që manifestuan interes për të mësuar sa më shumë detaje rreth letërsisë shqiptare, rreth krijimtarisë së Petro Markos dhe aspekte të tjera të kulturës shqiptare. Ngjarja u transmetua nga dy stacionet televizive lokale si dhe nga gazetatat më të rëndësishme lokale.

Mira Skënderi
Bukuresht

Homazh për të ndjerin Llazar Baloshi

Nuk vdes kurrë ai që le emrin e mirë

Një telefonatë e gjatë do të sillte lajmin e dhimbshëm atë të diel shtatori. Zilja binte por tingujt e saj të jepnin përshtypjen se nuk ishin si ato të zakonshmet...Ato paralajmëronin një diçka të pazakontë.

Ja dhe heshtja u thye: Llazi ndërroi jetë!

-Kush Llazi, ju lutem se s'po ju kuptoj.

Llazar Baloshi, -tha personi, me dhimbje.

-Do ta keni gabim sepse tek Llazi isha dje me gruan. Ishte disi mirë dhe priste nga çasti në çast që të linte spitalin dhe të shkonte pranë njerëzve të familjes që e donin dhe i donte shumë.

Por pak si nervozuar nga përgjigja ime, lajmësi vazhdoi: Lajmi është i vërtetë dhe nesër ora 10.00 bëhet varrimi!

Sinqerisht ndjemë dhimbjen e madhe që po ndaheshim nga një shok dhe mik i mirë. Por dhe pendesë që i folëm pak ashpër telefonuesit, se si i thonë fjalës: nuk është i keq lajmësi, por është vetë lajmi për raste të tilla të hidhura.

Llazar Baloshi lindi 74 vjet më parë në zonën e Elbasanit. U rrit si gjithë ne të tjerët e asaj kohe. Punoi për disa vite në zdruktharinë e repartit ushtarak të garnizonit të El-

basanit, ku me punën e sjelljen e tij fitoi respektin dhe dashurinë e shokëve të punës dhe të banorëve të zonës ku jetonte, aq sa ata e kishin bërë zakon ta thërrisnin "usta Llazi!".

Në moshën e re bëri zgjedhjene duhur të jetës, duke u martuar me Violeta Trëndafilin dhe sëbashku krijuan një familje solide. Rritën, edukuan dhe arsimuan dy djemtë: Sotiraqin dhe Ilirin; djem të mirë shembullorë që dhe ata tashmë kanë krijuar familjet e tyre të mira, në gjurmët dhe traditat e prindërve.

Meraku i tij i madh ishte tek nipi

i tij i dashur, Juri. Me dëshirën e gjyshit që nipi të kishte rezultate sa më të larta në mësim, e çonte dhe e merrte nga shkolla me përkujdesje shembullore.

Llazi, për arsye shëndetësore u largua nga Elbasani dhe erdhi në Durrës, ku shumë shpejt krijoi shoqërinë në të cilën e kalonte shumë mirë; i respektonte njerëzit dhe e respektonin. Kjo ndodhte sepse nga vetë natyra ishte i komunikueshëm.

Militoi në Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, Dega Durrës, ku dha ndihmesën e vetë. Ishte lexues i rregullt i gazetës "VETERANI".

Llazar Baloshi ishte energjik, i urtë, fjalëpak, njeri fisnik që të impononte respekt që në takimin e parë me të. Si të tillë atë e përcollën për në banesën e fundit familjarët, të afërmit, miqtë dhe shokët e shumtë, me lotë në sy, me dhimbje dhe kuro-ra të shumta me lule të freskëta.

Lamtumirë miku dhe shoku ynë Llazar! Prehu i qetë në tokën mëmë, ku të qoftë sa më i lehtë dheu, sepse i kreve me ndër detyrat si atdhetar, prind, gjysh, shok dhe mik i mirë.

Shefki LEKA
Nasi LIPE

Dega e OBVL Korçë analizon veprimtarinë e 9-mujorit 2013

Nga analiza e veprimtarisë së 9-mujorit të këtij viti, Dega e OBVL Korçë konkludoi për përmbushjen e detyrave të saj. Kryetari i kësaj dege, Z.Fluturak Vinçani foli për kompaktësinë e organizatës dhe efektivitetin e veprimtarisë së veteranëve korçarë, megjithë moshën e tyre te thyer e vështirësitë e ndryshme.

Veprimtaria e kësaj dege ka konstituar në ruajtjen dhe transmetimin tek brezat e rinj të vlerave të Luftës Antifashite Nacionalçlirimtare.Për këtë janë zhvilluar veprimtari të ndryshme në përkujtim të ngjarjeve e fugurave të shquara të LANÇ-it.

Gjithsesi, në përmbushjen me sukses të aktivitetit të saj OBVL, dega Korçë nuk ka patur mbështetjen e duhur nga organet e pushtetit vendor. Kryesia shprehu shqetësimin për faktin se marrëdhëniet me drejtuesit e pushtetit lokal nuk janë të mira dhe veçanërisht për faktin se propozimi për të shpallur qyetetarë nderi tre veteranëështë zvarritur. Megjithëse nga kontaktet me kryetarin e Këshillit të Qarkut është premtuar se këto propozime do të konsiderohen, ende nuk ka ndonjë vendimmarrje konkrete.

Një shqetësim tjetër që doli nga kjo mbledhje ka të bëjë me pagesën e taksave, sepse veteranët zvarritennëpër zyrat respektive, ndonëse kryesia I ka ndihmuar me sa mundësi ka patur.

Po kështu u trajtua edhe shëndeti i veteranëve.Anëtarë të kryesisë kanë vizituar veteranët e sëmurë dhe janë ndihmuar Brenda mundësive.

Nga kjo mbledhje u bë dhe zëvendësimi i anëtarëve të kryesisë që nuk jetojnë, me anëtarë të tjerë që janë veteranë ose pasardhës. Kështu të ndjerët Taqo Zavalani dhe Bajram Zaimi u zëvendësuan nga Qirjako Pici dhe Shyqyri Terolli. Kryesia përcaktoi edhe detyrat për të ardhmen.

Fluturak VINÇANI